



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 21, 22, 23, 28 dhe 29 maj 2018.
2. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për profesionin e avokatit”.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Nasip Naço, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Silva Caka, Tom Doshi.

Të ftuar:

Toni Gogu - Zëvendësministër i Drejtësisë

Ardian Shega - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit

Maksim Haxhia - Kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatëve

Rezarta Abdiu - Drejtore e Trajnimit Vazhdues në DHKA

Korajlka Bumçi – eksperte e misionit ndërkombëtar EURALIUS

Gianluigi Pratola - ekspert ndërkombëtar

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me rendin e ditës.

Në fillim kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 21, 22, 23, 28 dhe 29 maj 2018. Procesverbalet u janë dërguar me *e-mail* të gjithë kolegëve të komisionit. Ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratoohen procesverbalet e mbledhjeve të komisionit të datave 21, 22, 23, 28 dhe 29 maj 2018.

Në pikën e dytë të rendit të ditës kemi vazhdimin e shqyrtimit nen për ne të projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni ynë është komisioni përgjegjës. Relator i këtij projektligji është kolegu Adnor Shameti.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: Toni Gogu - zëvendësministër i Drejtësisë, Ardian Shega, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit, zoti Maks Haxhia, kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatëve, zonja Rezarta Abdiu, drejtore e Trajnimit Vazhdues pranë DHKA-së, zonja Korajlka Bumçi, eksperte e misionit ndërkombëtar EURALIUS, si dhe zoti Gianluigi Pratola, ekspert ndërkombëtar.

Mirë se keni ardhur zonja Bumçi, pas kësaj mungese!

Kemi edhe dy çështje të tjera në rendin e ditës, shqyrtimin dhe miratimin e projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017”. Edhe në këtë rast komisioni ynë është komisioni përgjegjës. Relatore është kolegja Xhina. Projektrezoluta është në tavolinën e kolegëve të komisionit.

Pika e fundit të rendit të ditës për sot është shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nismë e deputetëve. Komisioni përgjegjës është komisioni ynë. Relator është kolegu Adnor Shameti.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, vazhdimin e shqyrtimit nen për nen të projektligjit “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë.

Zoti Shameti, do t’ju lutem të ndjekim hap pas hapi nenet e mbetura për shqyrtim. Po ashtu do të kërkoja nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, por edhe të ekspertëve të EURALIUS-it që aty ku kanë ndërhyrje për nene

të caktuara të kërkojnë fjalën, pasi më parë projektligji është i dakordësuar në grupin e punës. E kemi lënë, në mos gaboj te neni 14.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Do të kërkoja mirëkuptimin tim që të vazhdojmë këtu ku e kemi lënë deri në fund. Pastaj për nenet që nuk i kemi mbyllur ende t'i sqarojmë në përfundim për metodologji të punës. Jemi dakord?

Ulsi Manja - Jemi dakord me propozimin e relatorit.

Nenin 14 nuk e kemi votuar.

Neni 14 “Mënyra e shpërblimit të avokatit”.

Adnor Shameti- Varianti i paraqitur para komisionit është varianti i dakordësuar me Dhomën Kombëtare, me Ministrinë e Drejtësisë dhe me përfaqësuesit e misionit EURALIUS. Në këto kushte ftoj anëtarët e komisionit ta miratojmë në variantin e paraqitur.

Ulsi Manja - Jeni dakord me nenin 14 me variantin që propozohet nga relatori dhe siç është dakordësuar? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15.

Adnor Shameti- Neni 15 ka të bëjë me ndërprerjen para kohe të shërbimit të avokatisë. Dua të sqaroj se varianti i paraqitur në komision është tashmë i dakordësuar si me Dhomën, me EURALIUS-in, ashtu edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë. Në këto kushte kërkoj miratimin në këtë format të nenit 15.

Ulsi Manja - Neni 15 “Ndërprerja para kohe e shërbimit të avokatisë”. Të dëgjojmë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

Toni Gogu – Kemi një pyetje të kjo pjesë. Vendosni asistentin në dy momente shumë të rëndësishme apo nuk është ky nen?

Adnor Shameti - Jemi te ndërprerja para kohe e shërbimit.

Ulsi Manja – Përfaqësuesit e ministrisë kanë ndonjë gjë? Nuk kanë. Po Dhoma e Avokatëve? Kolegët kanë ndonjë gjë?

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Ka një koment për disa terma dhe kam nevojë për saktësimin e disa termave. Termi “i përligjur” më duket se është term i rëndë për t’u përdorur në këtë rast. Termi i përdorur në çdo ligj është “shkaqe të arsyeshme”. Në pikat 4, 5 “shkaqe të përligjura” do të thotë që ligji i përcakton, kurse “shkaqe të arsyeshme” janë shkaqe që

gjykata herë pas here i vlerëson. Në të gjitha ligjet e mundshme procedurale përcaktohen “të arsyeshme” jo “të përligjura”, aq më tepër në këtë ligj mendoj se duhet termi “të arsyeshme”. Po kështu në pikën 7: “ Avokati “i emëruar” nuk emërohet, caktohet. Unë kërkoj përcaktimin e termit “caktohet”. Avokati i emëruar rishtas, caktohet avokat.

Ulsi Manja - Të vendosim një rregull, për ekonomi kohe.

Zoti Hyseni ju propozoni për pikat 4 dhe 5...

Alket Hyseni - Termi “të përligjur” të zëvendësohet me termin “të arsyeshme”.

Ulsi Manja- Të shprehet edhe Dhoma e Avokatëve.

Maksim Haxhia –Po, dakord.

Ulsi Manja- Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Ky term është përdorur në disa paragrafë, te 4, 5, 6 dhe 7, pra duhet të shikohet me kujdes.

Ulsi Manja- Biem dakord në parim që termi “i përligjur” të zëvendësohet me termin tjetër “i arsyeshëm”?

Adnor Shameti – Duke pasur parasysh diskutimin që kemi bërë me Dhomën e Avokatisë, me Ministrinë e Drejtësisë dhe me misionin EURALIUS për sa më sipër, jam i hapur që ta diskutojmë, por përmendja e termit “të përligjura” do të thotë vetëm për ato raste që ligji e parashikon specifikisht, prandaj është përdorur termi “të përligjura” jo “të arsyeshme”. Më kuptoni? Do të thotë vetëm për shkaqe të përligjura për ato që janë përcaktuar në mënyrë eksplicite në ligj. Në këtë kuptim ky lloj organizimi më duket korrekt.

Alket Hyseni - Ligji ky është “ Për avokatinë”, i cili rregullon ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem!

Adnor Shameti – Shikoni kuptimin, nuk ka lidhje me ndonjë ligj tjetër! Këtu ka lidhje me këtë ligj, që përcakton rregullimin e profesionit të avokatit. Nëse në këtë ligj do të themi shkaqet e përligjura, do të kërkojmë nëse në këtë ligj ka shkaqe të tjera apo jo. Mendojmë të përdorim të njëjtën gjuhë të arsyeshme, atë që legjislatori ka përdorur në ligjet procedurale që janë edhe më të rëndësishme. Pse duhet të tejkalojmë ligjet procedurale?

Ulsi Manja – Kjo është çështje e terminologjisë juridike. Jeni gjithë këta juristë këtu. Këtë nen nuk mund ta lë të hapur për të ndarë nëse do të përdorim termin “të përligjura” apo “të arsyeshme”. Jemi të gjithë juristë këtu. Ka një propozim që ta zëvendësojmë termin “i përligjur” me termin “të arsyeshme”. Doni ta hedhim në votim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht që nuk është njëlloj, se po të ishte kështu nuk do ta propozonte.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një pyetje për Dhomën Kombëtare të Avokatisë, por edhe për misionin EURALIUS. Në praktikën më të mirë dhe në kodin e ontologjisë së avokatëve i lejohet një avokati që ai për një arsye që e gjykon të arsyeshme të heqë dorë nga shërbimi para kohe apo ai është i detyruar ta mbrojë klientin dhe të heqë dorë vetëm kur ka shkaqe të përlligjura?

Ulsi Manja - Po, zoti Haxhia.

Maksim Haxhia - Avokati përderisa është në një marrëdhënie besimi që është kryesorja midis klientit dhe avokatit në çdo rast që vihet në dyshim, cenohet apo tronditet sadopak besimi është në të drejtën e avokatit për të mos lënë më mbrapa dyshime nga klienti ose që ta përdorë në të ardhmen, bën prezent vendimin e tij të heqjes dorë, por kjo heqje dorë është jopërfundimtare deri sa ai duhet të sigurojë një mbrojtje për të mos cenuar procesin. Ky është edhe rregulli i CCBE-së. Pra, e ke të detyrueshme që do ta shoqërosh klientin, deri sa i dorëzon dosjen, situatën dhe të gjithë praktikën avokatit tjetër.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Haxhia!

Adnor Shameti -Hidhe në votim tani.

Ulsi Manja - Nuk është puna për votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta hedhim në votim nenin 15. Misioni EURALIUS, a ka një mendim lidhur me përdorimin e kësaj terminologjie?

Korajlka Bumçi – *(përkthen përkthyesja)* Nëse e kam kuptuar saktë bëhet fjalë për paragrafin e parë të nenit 15.

Është në rregull, vetëm nëse i qëndrojmë afatit 15 - ditor që është në paragrafin e parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ta sqarojë zonja, të japë një mendim misioni EURALIUS për këtë gjë. Jemi 16 juristë dhe po zihemi për një fjalë.

Korajlka Bumçi - *(përkthen përkthyesja)* Termi “të arsyeshme” është më mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

... është mëngjes dhe e keni nisur si në pazar të Korçës.

Vasilika Hysi – Si pazari i Roskovecit!

Ulsi Manja – Jo, si pazari i Roskoveci ishte te projektligji tjetër, por unë po flas për Korçën!

Po, zonja, Bumçi.

Korajlka Bumçi - *(përkthen përkthyesja)* Në qoftë se themi vetëm “të arsyeshme”, kjo është shumë e hapur si shprehje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Pra, ju i qëndroni versionit siç është në tekstin e projektligjit? Atëherë, dakord!

Zoti Hyseni, i qëndroni versionit tuaj?

Alket Hyseni – I qëndroj, zoti kryetar, sepse më thoni një ligj, përveç rastit kur ka konflikt midis dy klientëve dhe avokati mbron njërin klient, se në cilat raste ligji e detyron avokatin të heqë dorë? Pra, në cilin paragraf apo nen në ligjet e Republikës së Shqipërisë përcaktohen rastet e dorëheqjes së avokatit? A mund të na i thoni këtu, që edhe ne t’i dimë? Nëse ka vetëm një, atëherë nuk mund ta lemë me një, por edhe nëse ka dy, sepse këtu po flasim për një moment të rëndësishëm të marrëdhënies midis avokatit dhe klientit të tij. Në një moment të caktuar, kur klienti ose avokati gjykojnë se marrëdhënia e tyre nuk shkon mirë, a do ta lemë këtë pjesë dhe do të gjejmë ligjin se ku do të referohen?

Prandaj, unë mendoj se ky është ligji që rregullon, ndaj të mos i ngatërrojmë gjërat. Ky është ligji dhe ky është neni që rregullon dorëheqjen e avokatit, sepse e keni edhe në titull: “Ndërprerja para kohe e shërbimit të avokatisë”. Nëse ne nuk i fusim këtu rastet, atëherë nuk kemi ku t’i gjejmë, ndaj duhet t’ia lemë arsyes, pra raste të arsyeshme, të justifikuara, në kuptimin që jo çdo rast, por raste, të cilat përbëjnë anën logjike, duhet të ndërpritet shërbimi i avokatisë.

Ulsi Manja – Zoti Haxhia, a keni ndonjë koment të fundit para se ta hedhim në votim?

Maksim Haxhia – Unë nisem nga praktika e përditshme që kemi me klientët. Propozimin e zotit Hyseni e shikoj me vend, që të lihet “e arsyeshme”, sepse jeta ka shumë dinamika dhe mund të nxjerrë argumente, të cilat nuk janë të parashikuara në ligj.

Për shembull, mund të sjellë një rast të fundit, që e kam në praktikën time. Në një përfaqësim vjen vëllai dhe motra që përfaqësonte babanë. Vëllai po ankohej pse po vonohej

procesi, kurse motra thoshte se çdo gjë ishte në rregull. Për këtë shkak ata po konfliktoheshin në syrin tim dhe unë u thashë që ose ta zgjidhnin midis tyre, ose unë si avokat do të ikja. Ky rast nuk është i parashikuar në ligj, por janë probleme, që kanë të bëjnë gjithmonë me marrëdhënien avokat- klient, dhe më kryesorja kanë të bëjnë me besimin. Nëse cenohet besimi, mund të dalin arsye nga më të ndryshmet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

Zoti Shameti, ju si relator, a do të gjeni një kompromis apo doni që ta hedhim në votim.

Adnor Shameti – Dakord!

Ulsi Manja – Pra, jeni dakord me propozimin e zotit Hyseni?

Adnor Shameti – Po, vetëm të mos kemi kundërshtime nga ana tjetër.

Ulsi Manja – Atëherë, kush është dakord me nenin 15, me sugjerimin e bërë nga zoti Hyseni? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Po, zonja Bumçi.

Korajlka Bumçi – *(përkthen përkthyesja)* Dëshiroj që t’i rikthehem edhe një herë nenit 14, ose më mirë le të përfundojmë me nenin 15 dhe të kthehem pastaj te neni 14. Në paragrafin e germës “c” të nenit 14 dua që të shtohet edhe Ministria e Financave.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja Bumçi, mbajeni shënim dhe kur ta votojmë ligjin në tërësi i rikthehem edhe një herë nenit 14 për të bërë vërejtjen apo sugjerimin që ju keni.

Zoti Shameti, nëse ligji është rakorduar nen për nen me grupin e punës, me Dhomën e Avokatisë, me Ministrinë e Drejtësisë dhe me misionin EURALIUS, unë do t’ju lutesha që të mos humbasim më shumë kohë me teknikalitete, ku mund të biem dakord që në momentin e propozimit.

Vazhdojmë me nenin 16 “Transferimi i veprimtarisë së avokatit”.

Adnor Shameti - Varianti i paraqitur ka gjetur dakordësinë e pjesëmarrësve këtu, ndaj mendojmë ta kalojmë kështu siç është.

Faleminderit!

Ulsi Manja - A ka ndonjë gjë për nenin 16 nga Ministria e Drejtësisë?

Dakord.

Hedhim në votim nenin 16. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kërkoj ndjesë, zoti kryetar, por mora Kodin e Procedurës Penale dhe po shikoj nenet që bëjnë fjalë për mbrojtjen e të pandehurit. Nga neni 48 deri në nenin 57, konkretisht në nenin 56, flitet për shkaqe të përligjura.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Sigurisht, duhet ta kishit hapur më parë Kodin, ta kishit parë më parë këtë gjë.

Këtu jemi të gjithë juristë me dy mendje, 15 vetë kemi 30 e ca mendje, ndaj jemi mbledhur gjithë këta ekspertët këtu për një projektligj.

Vazhdomë me nenin 17.

Adnor Shameti – Neni 17 “Ndërprerja e ushtrimit të profesionit të avokatit dhe kalimi në regjistrin pasiv”.

Varianti i paraqitur është i dakordësuar me pjesëmarrësit, ndaj duhet ta kalojmë me këtë format.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Mendoj se ka një lapsus te neni 17, paragrafi i dytë, ku thuhet “në rast dorëheqjeje”. Unë mendoj se duhet të jetë “në rast ndërprerjeje” që t’i përmbahet gjuhës së dispozitës. Është te fjalia e katërt, paragrafi i dytë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë nuk e di, por këtu thuhet “në rast dorëheqjeje”, ndërkohë që mendoj se duhet të jetë “në rast ndërprerjeje”.

(Diskutime pa mikrofon.)

A jemi duke folur për ndërprerjen? Ju këtu kemi futur dorëheqjen dhe unë mendoj se kjo duhet parë edhe një herë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, kryetar!

Nuk duhet të ngatërrojmë titullin e dispozitës, ku flitet për ndërprerjen e ushtrimit të profesionit të avokatit, sepse mund të ketë raste ku personi ka të drejtë të ndërpresë ushtrimin e profesionit.

Në paragrafin e dytë të këtij neni thuhet se avokati ka të drejtë të ndërpresë ushtrimin e profesionit të tij për disa arsye: mosha, sëmundja, leja e lindjes ose nëse jep dorëheqjen dhe nuk do ta vazhdojë më profesionin.

Pra, është një nga format e ndërprerjes së ushtrimit të profesionit të avokatit dhe kalimit në regjistrin pasiv.

Ulsi Manja - Pra, neni 17 do të hidhet në votim siç është propozuar në variantin e dakordësuar nga relatori dhe ekspertët.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 18.

Adnor Shameti – Neni 18 “Stazhi i kandidatit për avokat”. Varianti i paraqitur me të gjitha detajet këtu është i dakordësuar me Dhomën e Avokatisë, me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe misionin EURALIUS, kështu që mendoj ta miratojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është neni 18 “Stazhi i kandidatit për avokat”.

Ulsi Manja – Po, ka një propozim nga zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Vërtetimi pranohet sot nga Dhoma e Avokatisë edhe kur e lëshojnë zyrat e avokatisë, por edhe kur e lëshojnë avokatë të veçantë. Kjo është e logjikshme se zyra është entitet më vete.

Ulsi Manja – Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Gjuha e përdorur në këtë paragraf të neni 18 edhe më tej duhet të qëndrojë ajo që është, sepse edhe zyrat në vetvete janë një bashkim avokatësh. Kështu që edhe vërtetimet e praktikës i lëshon secili prej avokatëve, jo në cilësinë e përfaqësuesit të zyrës. Në këto kushte varianti i paraqitur duhet të kalojë kështu siç është.

Faleminderit!

Ulsi Manja – A ka diçka nga përfaqësuesi i Dhomës së Avokatisë?

Maksim Haxhia – Ne këtë problem e rregullojmë me statut se si veprohet, por nëse doni ta vendosni edhe këtu, nuk ka problem.

Në momentin që thuhet “çdo avokat”, bëhet fjalë për të gjithë avokatët dhe nuk ia lë më zyrës. Pra, sot çdo avokat që plotëson kushtet e neni 2, por edhe zyrat, si entit juridik, që lëshojnë vërtetime, pranohen nga Dhoma e Avokatisë. Kjo gjë bëhet me statut, sepse nuk ka një ligj që e parashikon. Pra, sot që ne do ta bëjmë në ligj e kufizojmë dhe do të dalim në një taktikë të re. Pra, sot zyrat e avokatisë nuk do të kenë të drejtë të lëshojnë vërtetime për të bërë stazhin.

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Unë kam diçka tjetër në lidhje me paragrafin e tretë të këtij neni. Ne për herë të parë rregullojmë shumë mirë në ligj që kandidati për avokat do të realizojë një stazh 1-vjeçar në formën e një *internship*-i. Kam një pyetje, që e kemi diskutuar edhe në konsultimin publik.

A është kjo periudhë stazhi me pagesë për kandidatin për avokat? A do të ketë ndonjë pagesë të sigurimeve shoqërore? A do të ketë ndonjë regjistër, ku do të mbahet për efekt të përvojës së tij e të tjerë? Kjo është një çështje që lidhet edhe me marrëdhëniet e punës.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – Kjo është një marrëdhënie pa pagesë, është një stazh që kryhet dhe nuk ka detyrime financiare dhe as detyrime tatimore. Si në të gjithë botën *internship*-i është një praktikë që trajnon praktikantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Absolutisht! Madje ne e kemi problem, sepse Dhoma e Avokatisë do të ndërhyjë nëse në një studio gjen praktikantë, duke na thënë se po i mbajmë jashtë rregullave. Dhoma në këtë rast përcakton rregullat dhe modalitetet, sepse praktikantët, në kuadrin e *internship*-it, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë, që konfirmohet dhe u bëhet me dijeni edhe organeve tatimore.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ju lutem, zoti Haxhia, a keni ndonjë koment edhe për pikën 3, të bërë nga kolegu Hyseni?

Maksim Haxhia – Unë jam dakord që të jenë edhe zyrat e avokatisë.

Ulsi Manja – A ka komente të tjera?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Në vijim të kësaj që tha zoti Hyseni, kam nevojë që të sqarohem për një çështje. Sot, në praktikë, po ndodh që vërtetimin për një stazhier e jep qoftë një avokat apo një studio ligjore.

Pyetja ime në parim është: në fakt, stazhierin e mëson avokati, në kuptimin e individit, i cili ka një arsenal të caktuar njohurish dhe ia transferon stazhierit, apo stazhierin do të kuptohet edhe si një person që i vjen në ndihmë të gjithë studios së avokatisë? Unë e konceptoj si individuale, por në qoftë se e ndajmë që do të jetë ndryshe, kjo e zgjidh çështjen dhe mund t'ia vendosim edhe studios së avokatisë. Në qoftë se do ta quajmë *personal trainer*,

pra trajner personal, për stazhierin do të jetë avokati. Pra, a e ndani ju si Dhomë këtë gjë? Si e konceptoni ju këtë gjë? Më pas ne mund të vendosim, sepse për ne njëlloj është.

Së dyti, në vijim të asaj që tha zonja Hysi, unë jam shumë dakord që stazhieri në të gjithë botën, gjatë kohës që mëson një profesion, paguan për ta marrë atë profesion, kurse ne e kemi pa pagesë dhe pa detyrime të tjera për avokatin që e mëson apo për studion. Në fakt, këtë gjë e kam për verifikim nga këshilltarët e komisionit. Sot ne kemi një ligj për punën vullnetare, për *internship*-et, për stazhierët, ku parashikohet se për këto punë paguhet minimumi i sigurimeve shoqërore. Ne duhet ta harmonizojmë, sepse nuk bëhet fjalë për pagesë, por për një kontribut për detyrimet e sigurimeve shoqërore, në mënyrë që të jemi në rregull edhe me ligjet e tjera në Shqipëri.

Ulsi Manja – Po, zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – Lidhur me pyetjen e parë, dua të sqaroj se studioja vepron si një subjekt i unifikuar. Kështu që kur është një individ, pra një avokat, kuptohet se stazhieri do ta marrë profesionin nga avokati, kurse kur është një studio do ta marrë nga studioja. Studioja ka një centralizim dhe përfaqësohet me emrin e saj dhe një praktikant nuk mund të marrë dot vërtetimin vetëm se e ka kryer stazhin nga një avokat i studios, sepse avokati mund të lëvizë në gjysmë të stazhit, kështu që autoriteti komunikues mbetet studioja.

Për sa i përket pyetjes së dytë, mendoj se ajo do të na vendosë në rrezik, sepse do të cenohet dhe studiot nuk do të marrë fare praktikantë. Si e kam zgjidhur unë në studion time? Kur vijnë në studion time unë u jap shpërblime për punë. Për shembull, kur ai atashohet pranë një avokati dhe ajo çështja ka sukses, i jap një shpërblim, ose një bonus për ta motivuar për kohën që ka harxhuar dhe për atë kontribut modest që ka dhënë. Bonusi që unë i jap është i pamatshëm, nëse do të vendosim që të vihet bonus dhe të tatóhet, do ta kemi shumë të vështirë. Efekti financiar është zero, por problemi është që studiot nuk do të marrin stazhierë, mund të marrin tri studio, por ne kemi gjithë këta studentë që do të diplomohen, janë rreth 2000 e sa studentë nga të gjitha fakultetet, private dhe publike. Ne po heqim shumë për të investuar që studiot të marrin sa më shumë. Po të jetë kështu, atëherë do t'i shkëpusim, do t'u vëmë një barrierë dhe studiot do të tregohen indiferente.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Për pyetjen e parë jam shumë e qartë që do të jetë edhe avokati edhe studioja dhe ka nevojë të shtohet propozimi që bëri zoti Hyseni. Ndërkohë që për pjesën e dytë e kuptoj edhe shqetësimin që studiot, po të kenë detyrim të paguajnë sigurimet dhe

kontributet e sigurimeve shoqërore, nuk do ta kryejnë këtë detyrë, ama, që të jemi në rregull dhe në harmoni me legjislacionin aktual, na duhet të formulojmë në këtë nen një parashikim që periudha e stazhit është e përjashtuar, sepse nesër në praktikë do të ndodhë që do të vijë tatimorët dhe, sa ta sqaroni ju në mënyrë administrative, do të krijohet ngërçi. Prandaj duhet dhënë e qartë këtu.

Dy minuta kohë na duhen sa të mendojmë një formulim, nëse të gjithë jemi dakord.

Vasilika Hysi – Gjithashtu, në vazhdim të këtij diskutimi që po bëjmë, kjo është shumë e nevojshme për të llogaritur përvojën e punës që do të ketë një person. Shpesh në këtë komision, kur kemi diskutuar për kandidatë për KLGJ-në dhe KLP-në kemi pasur debat nëse përvoja e stazhit do të quhet përvoja 15-vjeçare punë apo jo. Kjo është edhe për t'u dhënë fund praktikave të shfrytëzimit në punë të personave dhe abuzimeve që mund të kenë për ta paraqitur dikë, që është punonjës i një zyre, sikur është stazhier ndërkohë që ai mund të jetë punonjës, i cili punon pranë një zyre për një periudhë jashtë stazhit. Këto janë dy arsytet pse e bëra këtë pyetje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Haxhia.

Maksim Haxhia - Kjo është e zgjidhur, sepse ne e pajisim stazhierin me ID një-vjeçare të veçantë. Nëse kjo është karta vjetore e avokatit, të tillë kemi edhe për asistentët.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Unë jam pak ngacmues me termat, ai që duhet të themi është kartoni i avokatit, term shumë popullor, karta e identitetit të stazhit ose karta personale, të mos e ngatërrojmë kartën me dokumentin e identifikimit.

Maksim Haxhia – Ne kemi karta personale.

Alket Hyseni – Po, karta e kandidatit e quajmë.

Vasilika Hysi – Në pikën 7 të këtij neni që po diskutojmë, pra të nenit 18, që është neni 17 i projektligjit të depozituar, thuhet që Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë pasi bën verifikimet, e regjistron dhe e pajis atë me kartën personale të identitetit. Ajo që duhet rregulluar është që 6-ta dhe 7-ta duhen unifikuar në terminologji. Do të themi “karta personale e kandidatit për avokat”.

Alket Hyseni – Pika 7 të jetë pika 6 dhe pika 6, me korrigjimin e termit, të jetë pika 7.

Ulsi Manja – Dakord.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Kjo duhet bërë “dokumenti” dhe jo “kartë”, sepse “kartë” është turqisht. Ne duhet ta bëjmë ligjin të shqipëruar dhe termi “dokument” është më i shqipëruar, se e tha edhe avokati dhe jemi në rregull.

Ulsi Manja – Pra, ka një sugjerim nga zoti Fino për të shqipëruar këtë term.

Vasilika Hysi – Kam edhe diçka, këtë duhet ta shohë këshilltarja e komisionit edhe për pikat 5, 6 dhe 7, pasi kemi përdorur këtë terminologji në tri pika të nenit.

Ulsi Manja – Zonja, Bumçi ka kërkuar fjalën.

Korjalka Bumçi – *(përkthen përkthyesja)* Dua të reflektoj përsëri dhe përderisa është në ligjin tuaj tatimor, duhet të ketë një përqindje minimale për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor. Përderisa edhe në ligjin tuaj dhe duhet bërë një pagesë.

Ulsi Manja – Po, zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – Po ju sjell eksperiencën time familjare. Unë kam fëmijën tim në Angli dhe studiot nuk marrin absolutisht. Ai ka bërë tri praktika vjetore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Intership është. Edhe fëmija tjetër ka bërë praktikën pas universitetit.

Ulsi Manja – Mund ta ndërpres shqyrtimin nën për nen të projektligjit “Për profesionin e avokatit” dhe të vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, e kam shumë të lehtë ta bëj. Të merremi vesh dhe të ecim me ligjin dhe jo të diskutojmë pa dëgjuar njëri-tjetrin, se nuk ka vlerë diskutimi nëse nuk dëgjojmë njëri-tjetrin.

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Zoti kryetar, duhet të kuptojmë se çfarë është stazhi. Stazhi është një koncept i praktikës mësimore, aq më tepër që ne kemi hyrë në konceptin e shkollës së avokatisë, por me raste përjashtimore. Po të marrim eksperiencën e shumë vendeve, me qindra e mijëra studentë shqiptarë punojnë pa asnjë sigurim, falas si stazhier nëpër studio. Unë vetë, kur kam qenë avokat, kam punësuar studentë, të cilët nuk kanë pasur asnjë sigurim shoqëror dhe jo për një vit, por shumë më tepër, e nderuar zonja Bumçi.

Vërtet Shqipëria do të bëjë ligjet më të përparuara se Europa, por mos na vini lakun në fyt, sepse nuk do të zbatohet nesër në praktikë. Asnjë avokat nuk ka interes të marrë stazhierin aty që ta paguajë, kështu që do t’ia ngarkosh barrën stazhierit që t’ia paguajë vetes këto.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Relatori të na bëjë një përmbledhje lidhur me nenin 18.

Adnor Shameti – Në pikat 2 dhe 3 të nenit 18 sugjerojmë që të shtohet “apo zyrë avokatie” si në pikën 2 ashtu dhe në pikën 3. Në lidhje me diskutimin me apo pa pagesë për stazhierët pranë avokatit apo zyrës së avokatisë, unë bashkë me personat e interesuar, pra ministrinë, DHKA-në dhe misionin EURALIUS e kemi rënë dakord që duhet të jetë varianti pa pagesë. Në të kundërt rrezikojmë shumë që shumë prej të rinjve që diplomohen dhe duhet të bëjnë stazhin, të mos merren, të mos e bëjnë dot kurrë stazhin dhe ta kenë një pengesë, pasi avokatët edhe kështu dhe me zor të madh i marrin pranë tyre.

Në përfundim, në lidhje me ndryshimin e vendeve të pikave 6 dhe 7 unë them të bëhet me riformulimin “karta e identitetit” dhe jo “kartoni”.

Ulsi Manja – Zonja Bumçi e ka fjalën.

Korjalka Bumçi – (*përkthen përkthyesja*) Ne nuk po flasim për pagesën, pra për punën që po bën praktikanti, por vetëm për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor, e cila është në skemën tuaj të pensioneve dhe në ligj, pra 0,03% duhet paguar.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zonja Bushka e ka kërkuar fjalën.

Klotilda Bushka – Unë mendoj se jemi të gjithë dakord që qëllimi i kësaj dispozite ka të bëjë me faktin që ne të mundësojmë të rinjtë që ta mësojnë profesionin, pra, duhet t’u krijojmë kushte studiove që t’i marrin. Pse duhet ta marrin studiot një të ri që ta mësojë zanatin, kur paskan detyrime? Kështu që këtë qëllim duam të arrijmë, por këtu ka një ngërç ligjor në lidhje edhe me Kodin e Punës, i cili parashikon që kontrata për mësimin e profesionit paguhet sipas skemës së kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme. Që t’i përgjigjemi qëllimit të nenit, duhet që në këtë nen të bëjmë një përjashtim dhe ta shkruajmë. Unë e kam bërë një formulim që mund t’jua paraqes.

Ulsi Manja – Po, mund ta lexoni.

Klotilda Bushka – “Kandidatët për avokatë, gjatë periudhës së stazhit, nuk paguhen dhe të gjitha detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore janë të përjashtuara nga kjo marrëdhënie. Periudha e stazhit njihet si periudhë vjetërsie në punë”. Nëse ne vëmë këtë kemi kaluar detyrimin që kemi nga ligji tjetër, pra që edhe *internship*-et duhet të kenë detyrimin për të paguar një minimum të sigurimeve shoqërore. Atje ku diskutojmë që do të jetë avokat dhe studio, duke iu përmbajtur terminologjisë së ligjit te pika 3 e këtij neni, unë nuk jam dakord të vëmë “avokat” apo “zyrë”, por ta vëmë “çdo avokat, person fizik, apo juridik”, se kështu e kemi referuar në fillim të ligjit në nenin 3. Pra, ta bëjmë për ta unifikuar. Këtë e rregullojmë si terminologji se është problemi më i vogël që kemi. Unë them të biem dakord që periudha e

stazhit nuk paguhet, në kuptimin e punës, domethënë nuk është punë e paguar, sepse është kontratë mësimi profesioni ku stazhieri mëson.

E dyta, avokati është i përjashtuar nga detyrimi për të paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për stazhierin.

E treta, periudha e stazhit patjetër që duhet njohur si periudhë e vjetërsisë në punë, sepse është një kohë e cila do t'i duhet profesionistit t'i njihet gjatë gjithë jetës.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zoti Braho.

Spartak Braho - Nuk mund të njihet kjo periudhë si periudhë vjetërsie në punë për aq kohë sa ai kryen stazhin, sepse do të fillojmë pastaj të kërkojmë shkollën etj. Për sa kohë nuk kontribuon te sigurimet shoqërore, nuk mund t'i njihet si vjetërsi në punë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Po, zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – Dhoma është indiferente për punën e stazhit është apo ajo vjetërsi në punë. Për sa i përket punës, unë jam dakord që të shtohet dhe të jemi në rregull me tatimet. Studiot, gjatë kohës së stazhit, nuk kanë detyrime ndaj tatimeve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

A ka kush sugjerime për nenin 18?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj të shohim Kodin e Punës, ku rregullohet edhe mësimi i profesioneve, që të jemi korrekt, sepse ne nuk mund të bëjmë rregulla përjashtimore në një ligj të thjeshtë kur Kodi i Punës përcakton rregullat bazë.

Të jemi korrekt me Kodin e Punës.

Ulsi Manja – Si e ka Kodi i Punës?

Klotilda Bushka – Kodi i Punës, nëse i referohemi nenit 17, përkthehet te neni i projektligjit që po diskutojmë, si kontratë mësimi profesioni dhe për këtë kontratë kanë një minimum të detyrimeve, por që nuk lind nga Kodi i Punës, por nga ligji i sigurimeve dhe i kontributeve shoqërore. Kjo është baza e kontratës së mësimi të profesionit. Ne thjesht po përpiqemi t'i harmonizojmë të gjitha dispozitat që kemi në fuqi, me qëllim që kur të zbatohet nesër nga një kontroll tatimor... Marrim një rast konkret: një kontroll tatimor shkon në zyrën e avokatit, gjen stazhierin të pasiguruar me sigurime. E para, do t'i vërë gjobën. Nëse nuk e ka si përjashtim në ligj, nuk do t'i shkojë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

E kalojmë nenin 18, e lëmë të hapur! Kam dëgjuar deri tani të gjitha diskutimet me radhë dhe asnjëri, me përjashtim të relatorit që ofron propozim konkret, nuk jep një sugjerim se si duhet të jenë pikat 3, 6 dhe 7.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Zoti kryetar, zonja Bushka e nisi mirë ta thoshte, por, me sa duket i bëri presion Vasilika dhe u tërhoq. Cili është qëllimi i këtij neni? Qëllimi është që stazhierët të shkojnë të zyra e avokatit që të mësojnë. Nisuni nga qëllimi jo nga pagesa!

E dyta, asnjë *intership* në botë nuk paguhet, asnjë *intership* nuk paguan sigurime shoqërore. A do t'i lëmë këto zyra avokatie që të marrin sa më shumë të rinj dhe t'i mësojnë dhe po që se është i zoti ai, se është treg, do të shpërthejë dhe do të bëhet me i mirë se marrësi, do të ecë dhe do të marrë më shumë para?

Prandaj unë mendoj se relatori ka të drejtë që ta miratojmë nenin siç është këtu, se kot po vonohemi kaq gjatë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë.

Toni Gogu – Kam një pyetje te paragrafi 8. Është momenti kur stazhieri merr pjesë në disa momente shumë të rëndësishme procedurale. Faza hetimore është një moment shumë i rëndësishëm. Mbikëqyrja e avokatit është mbikëqyrje me praninë e avokatit? Pra, stazhieri mund të përfaqësojë në fazë hetimore nën mbikëqyrjen fizike të avokatit?

Ulsi Manja – Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Mendoj të qëndrojë në këtë format, pasi në një dispozitë tjetër i kemi të sqaruara qartazi rastet dhe tagrat që ka asistenti gjatë periudhës së stazhit. Kështu që nuk ka nevojë për përpunim të mëtejshëm kjo dispozitë. Kemi të bëjmë me raste minore në përfaqësimin e kundërvajtjeve penale, sikurse e kemi paraqitur në ligj, dhe në hartimin e akteve proceduralë në rastet civile. Kurdoherë është kusht i panegociueshëm dhënia e pëlqimit të klientit, nga njëra anë, dhe është nën përgjegjësinë e plotë të avokatit, që është duke mbikëqyrur dhe duke drejtuar stazhin, nga ana tjetër.

Toni Gogu – Ne si ministri kërkojmë zëvendësimin e fjalës, do të sugjeronim praninë e avokatit. Qëllimi i nenit është që stazhieri të mësojë zanatin, nuk është që ai të kryejë punë të deleguara.

Ulsi Manja – Ka praktikë Dhoma Kombëtare e Avokatisë për këto gjëra lidhur me pikën 8 të nenit 18. Ju lutem, si vepohet kur stazhierët sot, shkojnë dhe përfaqësojnë çështjet në gjykatë?

Toni Gogu – Janë gjithmonë nën praninë e avokatit.

Ulsi Manja – Në pikën 8 thuhet: “Kandidati për avokat ka të drejtë të përfaqësojë apo të mbrojtë të interesuarin në fazën hetimore, në gjykimin e kundërvajtjeve penale me autorizimin dhe nën mbikëqyrjen e avokatit”. Këtë po thotë zëvendësministri, të hiqet termi “mbikëqyrës” dhe të vihet “në praninë e avokatit”. Nëse sot vepohet me praninë e avokatit, të vendoset termi i duhur!

Tani, për nenin 18, pika 3 ka një sugjerim që të “çdo avokat” të shtohet termi “zyrë avokatie”. E njëjta gjë edhe për pikën 2. Ka një sugjerim që pika 7 të ndërrojë vendin me pikën 6, dhe të rregullohet terminologjia e përdorur, pra nga “karta e identitetit” në “karta personale e identitetit”. Gjithashtu ka një sugjerim për periudhën e stazhit për ta përjashtuar nga kontributet e sigurimeve shoqërore.

A jam i qartë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi edhe një herë, zonja Bushka të na sqaroni në lidhje me këtë çështjen e stazhit?

Korajlka Bumci – Si është në Kodin e Punës?

Klotilda Bushka – Në Kodin e Punës te paga minimale, neni 111 thotë: “Këshilli i Ministrave mund të caktojë një pagë më të ulët se sa paga minimale në shkallë vendi për rastet e mësimit të profesionit në sistemin e arsimit dhe formimit profesional në formën e dyfishtë, për efekt të sigurimeve shoqërore”.

Ulsi Manja – Është për arsimin profesional, futet edhe te ligji i avokatisë.

Klotilda Bushka - Neni tjetër, neni 17 te kontrata e mësimit të profesionit thotë se dispozitat e Kodit zbatohen edhe për kontratën e mësimit të profesionit. Neni 18 thotë: “Këshilli i Ministrave parashikon rregulla të veçanta për kontratat dhe kontratën e mësimit të profesionit. Mund ta lamë edhe pa e rregulluar këtu, por...”

Ulsi Manja – Edhe një herë të flasë relatori, para se ta hedh në votim.

Adnor Shameti – E fundit fare, unë i qëndroj asaj që kandidatët për avokat duhet të përjashtohen nga pagesa e sigurimeve shoqërore, sepse ashtu siç ka gjuhën Kodi i Punës, që ia lë Këshillit të Ministrave ta rregullojë me një VKM, i cili është një akt nënligjor, edhe ne

kemi të gjitha të drejta që me këtë ligj të veçantë ta parashikojmë shmangien e pagesës së sigurimeve shoqërore.

Ulsi Manja – Faleminderit, relatorit!

A jeni dakord me sugjerimet që u bënë për pikat 3, 6, 7 dhe 8? Dakord.

Hedhim në votim nenin 18, me sugjerimet që u bënë.

Kush është dakord me neni 18?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 19.

Adnor Shameti – Neni 19 ka të bëjë me provimin e kualifikimit të avokatëve. Gjuha e përdorur në variantin e paraqitur para jush është e dakordësuar me Ministrinë e Drejtësisë, Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe me zyrën e EURALIUS-it.

Ju ftoj ta kalojmë me këtë variant.

Faleminderit!

Ulsi Manja – A jeni dakord me nenin 19?

Maksim Haxhia – Dhoma Kombëtare e Avokatisë është dakord.

Ulsi Manja – A është dakord Ministria?

Toni Gogu – Kemi një pyetje për kufizimin me 4 herë të provimit, e paragrafi 5. Domethënë që mund të jepet provimi deri në 4 herë, ndërkohë që e dimë që është një çështje në gjykim e sipër për heqjen e këtij kufizimi. A e keni parashikuar një gjë të tillë?

Ulsi Manja – Ministria sugjeron që të hiqet kufizimi?

Po, përfaqësuesi i dhomës.

Maksim Haxhia – Ne jemi nisur nga praktika botërore, që ka një numër të kufizuar herësh për të dhënë provimin e avokatisë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, relatori.

Adnor Shameti - I qëndroj variantit të paraqitur.

Ulsi Manja – Çfarë mendimi ka misioni EURALIUS për kufizimin në pikën 5?

Korajlka Bumci –(përkthen përkthyesja) Nuk e di praktikën ndërkombëtare, por ne nuk kemi kufizime, por për mua janë mirë të dyja versionet, pra edhe nëse dëshironi të vendosni një kufizim, për ne është në rregull.

Alket Hyseni – Vendosja e një numri limit ndihmon në disiplinimin e kandidatëve që ata të jenë më të përgjegjshëm dhe ta dinë se nuk mund të futen pa limit, se ndonjëherë abuzohet edhe me të drejtat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Koha jo, sepse ai mund ta ketë ëndërr, mund të bëhet edhe 60 vjeç.

Ulsi Manja – Në të dyja variantet që propozohen qëllimi nuk është i keq. Interesi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë është që të jetë i pakufizuar, sepse ai do të paguaje *fee*-në sa herë që regjistrohet për të dhënë provimin e avokatisë. Mua më duket se në variantin që propozohet është i rregulluar. Nëse pas këtyre 4 herëve nuk e merr provimin mund të punojë jurist sa të dojë, por që të përfaqësojë interesat e klientit në gjykatë, kur nuk ka marrë 4 herë provimin, nuk shkon. Të bëjë fakultetin, të bëjë dy vjet shkollë avokatie, të hyjë 4 herë në provim dhe të mos e marrë, atëherë ky njeri mund të punojë si jurist, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mendoj se neni 19 është mjaft mirë i rregulluar.

E hedhim në votim.

Kush është dakord me nenin 19, sipas variantit që propozohet?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 20.

Adnor Shameti – Neni 20 ka të bëjë me rastet përjashtimore, varianti i paraqitur është i dakordësuar me ministrinë, Dhomën dhe me misionin EURALIUS.

Ju ftoj ta kalojmë në këtë format që është paraqitur!

Ulsi Manja – Zonja Xhina ka kërkuar fjalën.

Elena Xhina – E kam thjesht për terminologjinë. Bëhet fjalë për paragrafin e dytë “personeli akademik me kohë të plotë i lëndëve juridike” mendoj se do të ishte më mirë “i lëndës të së drejtës”. Pra, propozoj të mos thuhet “i lëndëve juridike”, por “i lëndës të së drejtës”, se ka universitete që nuk kanë fakultete juridike brenda dhe japin lëndë të së drejtës në degë të tjera. Është paragrafi i dytë, fjalia e parafundit.

Ulsi Manja – “Me kohë të plotë i lëndëve juridike në institucionet e arsimit të lartë”.

Elena Xhina – Mendoj ta themi: “...lëndës të së drejtës dhe juridike”, për faktin se ka universitete që nuk kanë fakultete të drejtësisë apo juridik dhe lëndët e së drejtës jepen te Fakulteti Ekonomik.

Ulsi Manja – Atëherë e hedhim në votim.

A është dakord Dhoma Kombëtare e Avokatisë me nenin 20? Dakord.

Ministria e Drejtësisë? Dakord.

Edhe misioni EURALIUS është dakord.

E hedhim në votim nenin 20, sipas variantit të dakordësuar në grupin e punës.

Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 21. Avokati i huaj.

Adnor Shameti – Neni 21 ka të bëjë me avokatin e huaj. Varianti i paraqitur është i dakordësuar me ministrinë, Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe me misionin EURALIUS, kështu që ju fton ta kalojmë dhe ta miratojmë në këtë format që është paraqitur.

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, keni ndonjë sugjerim për nenin 21?

Alket Hyseni – Kisha një pyetje: pse keni lëvizur nga varianti i ekspertëve, të cilët e kanë edhe nga praktika ndërkombëtare, 5 vjet ushtrimi, ndërsa ju shkoni në 3 vjet? Cila është arsyeja? Gjithashtu, formulimi i nenit 20, sipas ekspertëve...

Ulsi Manja – Neni 21.

Alket Hyseni – Ka kaluar neni 21...

(Diskutime pa mikrofon)

Ka lëvizur si numër në variantin që kemi përpara, por ka qenë neni 20 “Avokati i huaj”. Formulimi është shumë konciz, shumë i saktë, pa ujëra dhe mendoj të mos e bëjmë ligjin...

Unë po shoh në pikat 3 dhe 4 disa elemente që Dhoma i zgjidh me statut, prandaj të mos i fusim të gjitha gjërat në këtë linjë. Në pikën 3 thuhet: “Dhoma e Avokatisë, pasi vërteton përmbushjen e kriterëve...”. Ne i dimë këto, sepse Dhoma ka një procedurë, pasi vërteton përmbushjen e kriterëve, do t’i miratojë, janë gjëra që i zgjidh statuti, kurse formulimi në nenin e mëparshëm ka qenë ky, më lejoni t’jua lexoj: “Profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë ka të drejtën ta ushtrojë edhe çdo shtetas i huaj me kushtin që të zotërojë titullin avokat në një shtetet anëtar të BE-së dhe të ketë nënshkruar një kontratë bashkëpunimi me një studio avokatie në Republikën e Shqipërisë, e njohur dhe e regjistruar si e tillë në Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë dhe në organet tatimore. Pesë vjet pasi kanë ushtruar veprimtarinë e tyre sipas kësaj pike, ata gëzojnë të drejtën e fitimit të titullit avokat, rezident në Republikën e Shqipërisë”.

Pika 2: “Komiteti Drejtues i Dhomës së Avokatisë njih titullin avokat të fituar nga ai person me shtetësi shqiptare në një shtet të huaj, kryesisht anëtar i Bashkimit Europian, dhe mbi këtë bazë bën konvertimin me titullin e avokatit. Kriteret e hollësishme caktohen në statutin e Dhomës”. Pra, t’i lëmë edhe Dhomës disa rregullime dhe të mos fusim në listë disa gjëra kot fare. Shikojini pikat 3, 4 dhe 5, janë tri pika që i ka rregulluar pika 2 shumë mirë, sipas gjykimit tim, afati të jetë 5 vjet, jo 3 vjet, sepse kaq është edhe në praktikën ndërkombëtare. Avokatët shqiptarë pa 5 vjet atje nuk mund të bëhen avokatë në asnjë vend, të kemi pak reciprocitet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zonja Hysi, ka disa pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Unë jam në vazhdim të shqetësimit dhe të pyetjes që bëri kolegu Hyseni: cila është arsyeja që neni 20 i projektligjit të depozituar ka ndryshuar në disa elemente? E para, a ka ndonjë praktikë në vendet e tjera ku me 3 vjet punë një avokat shqiptar të ushtrojë profesionin e avokatit në Itali, në Greqi, në Gjermani dhe në vende të tjera?

E dyta, a ka ndonjë rregull këtu për njohjen apo ekuivalentimin e titujve të avokatisë, që merr një person me shtetësi shqiptare në një shtet tjetër?

Po, avokatia që jepni ju, zoti Maksi, titulli që jepni ju, ekuivalentohet në vendet e tjera për 3 vjet?

Maksim Haxhia – Nuk jemi anëtarë të BE-së, kështu që...

Vasilika Hysi – Më falni!

Ne këtu themi në vendet e Bashkimit Europian, sipas rregullave të shtetit anëtar që e ka nënshkruar e të tjera.

E fundit, cilat janë arsyet që ju keni detajuar rregulla për mënyrën se si duhet të veprojnë Dhoma Kombëtare e Avokatisë, njohja ose ekuivalentimi i titujve të dhënë për avokatët në një vend tjetër?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Haxhia, e ka fjalën.

Maksim Haxhia – Faleminderit!

Ky është formulimi që është bërë më pas, sepse ne kemi pasur formulimin që tha zoti Hyseni. Pra, është një formulim miks për t’i paraprirë edhe integritet që do të bëjë vendi ynë në BE, duke e lenë të hapur me standardet e BE-së, në qoftë se do të integrohemi.

Për sa i përket pyetjes suaj, ne kemi marrëveshje me Italinë, me Dhomën Kombëtare të Avokatisë që, nëse një avokat shqiptar, i cili është diplomuar në Itali, do të shkojë të japë provimin për t'u bërë avokat dhe ta ushtrojë pranë Kamera Florence të Avokatisë, nuk e jep provimin me shkrim, i cili atje është shumë i vështirë dhe ka rreth 70% e shkallës së vështirësisë, por e jep provimin vetëm me gojë. Këtë marrëveshje ne e kemi zgjidhur në mënyrë bilaterale, sepse shkolla jonë e avokatisë është binjakëzuar dhe është me të njëjtat standarde të nivelit profesional.

Për sa i përket formulimit, më i saktë ishte propozimi ynë, i cili është ndryshuar dhe është lënë kjo, si një mënyrë komoditeti për të ardhmen dhe për të pasur më shumë standarde...

Tre vjeçari duhet, sepse është për vendet e Bashkimit Europian.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

Fjalën e ka kërkuar zonja Bumçi.

Koraljka Bumçi – *(përkthen përkthyesja)* Paragrafët 2 dhe 3 janë në përputhje me direktivën.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Shameti, kishit ndonjë gjë si relator?

Adnor Shameti – Përfundimisht unë i qëndroj variantit përfundimtar të miratuar dhe ky variant të kalojë për votim.

Alket Hyseni – Unë do të propozoja të rregullohej termi “jo vetëm shtetas i huaj”, por siç bëhet me shtetasit shqiptarë që kanë marrë titullin e avokatisë jashtë. Pra, duhet të themi: “Çdo shtetas shqiptar ose i huaj, që ka fituar titullin e avokatisë”.

Ulsi Manja – Dakord me sugjerimin?

Po.

Kush është dakord me nenin 21, së bashku me sugjerimin e kolegut Hyseni për pikën 1? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 21.

Kalojmë te Kreu IV “Organizimi, organet drejtuese dhe kompetencat”.

Neni 22 “Organizimi i avokatisë”.

Adnor Shameti – Neni 22 ka të bëjë me organizimin e avokatisë. Kemi gjetur dakordësinë nga subjektet e interesuara për variantin e paraqitur, kështu që kërkoj të kalohet në këtë format.

Ulsi Manja- Përfaqësuesit e Dhomës, jeni dakord?

Përfaqësuesit e ministrisë, jeni dakord?

Përfaqësuesit e EURALIUS-it, jeni dakord?

Kush është dakord me neni 22, sipas variantit të propozuar? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 22.

Kalojmë te neni 23 “Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë”.

Adnor Shameti – Neni 23 ka të bëjë me organizimin e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe varianti i paraqitur ka gjetur dakordësinë e të gjitha subjekteve të interesuara.

Faleminderit!

Ulsi Manja –Përfaqësuesit e ministrisë dhe të misionit EURALIUS janë dakord me nenin 23? Dakord.

Hedhim në votim nenin 23, sipas tekstit të dakordësuar në projektligj. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 23.

Neni 24 “Organet drejtuese të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë”.

Adnor Shameti – Neni 24 dhe varianti i paraqitur është dakordësuar me subjektet e interesuara, prandaj kërkoj të miratohet në këtë format.

Maks Haxhia – Dakord.

Ulsi Manja - Përfaqësuesit e ministrisë?

Toni Gogu – Dakord.

Ulsi Manja – Përfaqësuesit e misionit EURALIUS?

Korajlka Bumci – Dakord.

Ulsi Manja – Hedhim në votim nenin 24. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25 “Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë”.

Adnor Shameti – Në nenin 25 “Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë”, varianti i paraqitur është i dakordësuar me subjektet e interesuara, prandaj ju ftoj ta miratojmë në këtë variant.

Faleminderit!

Maksim Haxhia – Ne jemi dakord, por dua t’ju bëj me dije se është hequr fjala “kombëtar”, ky është ndryshimi. Pra, nuk do të jetë më Dhoma Kombëtare e Avokatisë, por Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

Përfaqësuesit e ministrisë jeni dakord?

Toni Gogu – Dakord.

Ulsi Manja – Zoti Fino, e ka kërkuar fjalën.

Bashkim Fino - Kam një pyetje për relatorin në lidhje me pikën e fundit të nenit. Pse numrin e përgjithshëm të Këshillit të Përgjithshëm të Avokative e vendos statuti i avokatit? A ka ndonjë problem?

Adnor Shameti – Është e vetërregulluar, e vetorganizuar, por këtë mund t'jua shpjegojë edhe kryetari i Dhomës.

Bashkim Fino – Se që këtu fillojnë ato hilet pastaj.

Ulsi Manja – Po, zoti Haxhia.

Maks Haxhia – Kjo është pasi numri i avokatëve shtohet vazhdimisht dhe në këtë mënyrë edhe përfaqësimi ndryshon.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Haxhia!

Hedhim në votim nenin 25. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Alket Hyseni – Zoti kryetar, ne jemi duke futur këtu gjëra, të cilat edhe mund të mos i fusnim dhe t'ia linim statutit të plotë, ndërkohë që, kur vijmë te gjëra themelore, siç është numri i një organi të rëndësishëm, i cili mund të shfrytëzohet, Maksi më ndjeni se nuk ka lidhje me emrat, në periudha zgjedhore, para periudhave zgjedhore, mblihet dhe e blinton situatën e një kaste të caktuar herë pas here dhe ne vuajmë nga kjo në Shqipëri.

Për shembull, zoti Fino, e ka vuajtur së fundi nga një organ i tillë...

Adnor Shameti – Jo, këtu kemi një kufizim të mandatit të kryetarit me dy mandate, kështu që nuk ekziston...

Alket Hyseni – Zoti relator, kjo nuk ka lidhje me kryetarin, por me institucionin. Këshilli i Përgjithshëm është organ më vete dhe nuk varet nga kryetari, këtë sapo e thamë që kryetari është një nga tre organet. Unë do të sugjeroja mundësinë që ta kishim të përcaktuar dhe të mos e linim evazive. Çfarë mund të bëjë tjetër ligji nëse nuk përcaktohen organet kryesore? Pra, po ta shihni, ne po merremi me garantimin dhe mbrojtjen e mjeteve ligjore, të të drejtave, gjëra të përgjithshme dhe nuk po merremi me gjëra konkrete dhe të mund ta përcaktonim numrin...

E mbështes zotin Fino në propozimin që ai bëri.

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Shameti, ta hedhim përfundimisht në votim nenin 25!

Adnor Shameti – Po, në variantin e paraqitur.

Ulsi Manja – Kolegu Hyseni ka një sugjerim për ta përcaktuar numrin ...

(Diskutime pa mikrofon)

87, por Dhoma thotë se ky numër mund të ndryshojë në varësi të...

(Diskutime pa mikrofon)

Maksim Haxhia – Ka diçka, sepse, po e vure 100, për shembull, më pas duhet kuorumi, por ne këtë e kemi zgjidhur. Përse kemi vajtur në këtë konkluzion? Ne kemi dhomat Lokale, dhomat Vendore dhe Dhomën e Tiranës, e cila ka peshën më të madhe specifike të numrit, kështu që me statut ne rregullojmë edhe mënyrën e përfaqësimit.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju nuk e vini dot sot, për mua mund ta vini dhe nuk ka ndonjë problem, por, po e vutë ju numrin, më pas do ta kufizoni, sepse do të rritet numri i avokatëve, i cili deri tani ka vajtur gati 10 mijë...

Ulsi Manja – Ju lutem, të mos ngelemi në këtë pikë, sepse nuk besoj se është e rëndësishme.

Hedhim në votim nenin 25, sipas variantit që propozohet në projektligj. Kush është pro? Kundër? 3 kundër. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet neni 25, sipas variantit të dakordësuar me grupin e punës.

Kalojmë te neni 26 “Komiteti drejtues i Dhomës Kombëtare të Shqipërisë”.

Adnor Shameti – Neni 26, i cili ka të bëjë me Komitetin Drejtues të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë në tërësinë e tij është riformuluar, dakordësuar dhe është dhënë miratimi nga të gjitha subjektet e interesuara, prandaj ju ftoj ta kalojmë këtë variant.

Ulsi Manja – Zonja Hysi ka një pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në krahasim me përmbajtjen e paragrafit 2 të këtij projektligji të depozituar, shikoj që është hequr mundësia që drejtori Administrativ i Dhomës të përzgjidhet, të propozohet nga kryetari nëpërmjet disa kandidaturave. Në variantin e dakordësuar është sjellë që kandidati për drejtor do të ketë vetëm një propozim nga kryetari i Dhomës. Cila është arsyeja që është hequr mundësia e pasjes së më shumë se një kandidati të propozuar për drejtor Administrativ nga ana e kryetarit të Dhomës së Shqipërisë?

Ulsi Manja – Zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – E para, kjo nuk ka qenë ndonjëherë. Ne e kemi vënë këtë me variantin që kryetari ka disa kandidatura dhe këto kandidatura ia propozon Komiteti Drejtues. Komiteti Drejtues e shqyrton dhe, nëse i miraton, në rregull, por, në qoftë se nuk i miraton,

shkohet te kandidatura tjetër. Ai është administrator i administratës, kështu që nuk ka pse të bëhet me 1, 2, 3 apo 4 kandidatura. Kjo bëhet me propozimin e kryetarit, sepse do të jetë bashkëpunëtori i tij më i afërt...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Çuçi e ka kërkuar fjalën.

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Kisha një merak te pika 2, germa “d”, sepse duhet të kemi kujdes te pasqyrat financiare vjetore, sepse këto bëhen audit sipas ligjit, kështu që...

Maksim Haxhia – Me audit i kemi ne, i ka Këshilli i Përgjithshëm...

Bledar Çuçi – Dakord, po këtu thuhet se vetëm miraton dhe harton pasqyrat financiare vjetore, por, në fakt, ato janë ligjërisht e drejtë e auditit të brendshëm.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju e caktoni, e kisha thjesht për ta pasur parasysh që të mos ketë probleme më pas.

Maksim Haxhia – Atëherë ajo duhet të jetë “e miraton” dhe jo “e harton”...

Bledar Çuçi - E miraton Komiteti drejtues, apo jo?

Maksim Haxhia – Po. Pra, ia propozon për miratim në fund fare Këshillit të Përgjithshëm...

Bledar Çuçi – Mirë pra, por...

(Diskutime pa mikrofon)

Maksim Haxhia – Keni të drejtë, kjo nuk ka qenë, por se si ka dalë kjo...

Edhe teknikisht nuk ka se si ta bëjë...

(Diskutime pa mikrofon)

E propozon dhe ia paraqet për miratim...

Ulsi Manja – Ju lutem, hedhim në votim nenin 26, së bashku me sugjerimet që bëri kolegu Çuçi, ku edhe Dhoma është dakord, pasi janë çështje të teknikës legjislative.

Maksim Haxhia – I paraqet për miratim.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 26, sipas variantit që propozohet në projektligj? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 26.

Neni 27 “Kryetari i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë”.

Adnor Shameti - Neni 27 ka të bëjë me kryetarin e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë. Varianti i paraqitur është i dakordësuar.

Më lejoni të qartësoj që me variantin e ri të paraqitur, në nenin 27 të sjellin një risi në ligjin për profesionin e avokatit, e cila nuk ka qenë deri më sot. Kryetari i Dhomës së Avokatisë do të ketë një mandat të kufizuar, ndryshe nga deri më sot, që ka pasur një mandat të pakufizuar. Në këtë kuptim zgjidhim edhe shqetësimet e zotit Fino, të zotit Hyseni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo me ligjin tonë!

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjala për zotin Fino.

Bashkim Fino – Jam kundër pikës 2, që kryetari të zgjidhet me mandat 4-vjeçar dhe të drejtën e një mandati tjetër, sepse po të kemi parasysh nenin 25, pikën 4, ai që ka bërë këtë nen, e ka bërë që kryetari Dhomës së Avokatisë të mos ketë dy mandate, por të jetë në vazhdimësi. Këtu kanë vepruar gabim. Jam kundër kësaj pike! Duhet të jetë... kush fitoi, fitoi! Po fitoi, të rrijë sa të dojë!

Ulsi Manja – Faleminderit për sugjerimin, zoti Fino!

Fjalën e ka zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Edhe unë kam rezervat e mia për pikën 2. Duke pasur parasysh që bëhet fjalë për organizimin e një dhome të profesioneve të lira, ku vetë anëtarët e Dhomës zgjedhin se cili është kryetari, pavarësisht se ju mund ta konsideroni si risi, për sa kohë është një proces zgjedhjeje, nuk mendoj se i duhet kufizuar e drejta, qoftë edhe kryetarit, që të kandidojë. Pastaj, nëse fiton, është një vullnet që zgjidhet me votën e atyre që janë të legjitimuar të votojnë. Kufizimi më duket si shkelje e së drejtës për të marrë pjesë në një proces transparent zgjedhesh.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjala për përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

Toni Gogu - Jemi dakord me variantin e projektligjit!

Do të doja të dija edhe mendimin e misionit EURALIUS.

Korajlka Bumci –*(përkthen përkthyesja)* Jemi dakord!

Ulsi Manja – Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Në përfundim, te pika 3 e nenit 27, kërkoj të bëhet një korigjim dhe të thuhet “statutin e Dhomës së Avokatisë” dhe jo “statutin e kryetarit”.

Bledar Çuçi – Thjesht edhe për terminologji, “kompetenca, statusi ose të drejtat dhe detyrimet”, pra, statusi është për organizatat. Duhet hequr fare fjala “statut” dhe themi: “Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e kryetarit”.

Ulsi Manja – Faleminderit për sugjerimin, zoti Çuçi!

Kemi një propozim nga kolegët Fino dhe Bushka për pikën 2, që kjo pikë të hiqet si kufizim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me të drejtë zgjedhjeje vetëm një herë...

Ju kërkoni që kjo pikë të hiqet fare, apo të hiqet vetëm paragrafi “me të drejtën e rizgjedhjes vetëm një herë”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, të hiqet fjala “vetëm një herë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për mandatin bëhet fjalë.

Propozimi i kolegëve është që pika 2 të jetë: “Kryetari zgjidhet me një mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje”. Të hiqet fjala “vetëm një herë”.

Si rregull, kur ka propozim, jam i detyruar ta hedh në votim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Rrëzohet propozimi i kolegëve Bushka dhe Fino!

Hedhim në votim nenin 27 me rregullimet që do t’i bëhen pikës 4 sipas propozimit të kolegut Çuçi.

Kush është pro nenit 27 sipas variantit me tekstin e projektligjit? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 27!

Kalojmë te neni 28 “Dhoma Vendore e Avokatisë”.

Adnor Shameti – Neni 28 ka të bëjë me Dhomën Vendore të Avokatisë. Varianti i paraqitur ka gjetur dakordësinë e subjekteve të interesuara. Ju ftoj ta miratojmë në këtë variant!

Faleminderit!

Ulsi Manja – Dakord me nenin 28?

Zoti Fino ka një pyetje.

Bashkim Fino – Jam kundër pikës 3 të nenit 28 dhe dua të mos e organizojmë numrin e dhomave të avokatisë në funksion dhe në raport të numrit të avokatëve, por të mund ta organizojmë mbi bazën e ndarjes së re territoriale të Shqipërisë, mbi bazën e ndarjes së

gjykatave, të strukturës që ato bëjnë, sepse, në qoftë se ju më thoni që unë do të krijoj një dhomë avokatie sipas numrit, në një bashki të vogël mund të mos kesh avokat dhe ti nuk krijon, ç' domethënë kjo? Atje prapë ka çështje. Kështu që unë jam kundër kësaj pike, relator, sepse numrin e dhomave duhet ta organizojmë mbi bazën e ndarjes territoriale ose të gjykatave, por jo sipas numrit të avokatëve!

Faleminderit!

Ulsi Manja – Fjala për relatorin.

Adnor Shameti – Nëse e kuptova drejt zotin Fino, bashkohem me sugjerimin e tij. Sugjeroj që në pikën 3 të shtojmë: “si dhe në përputhje me ndarjen e re territoriale”, sepse është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që të kemi avokat, ama dhomat i përcakton...

Ulsi Manja – Sot kemi bashki që nuk kanë gjykata.

Maksim Haxhia – Ne nuk kemi lënë qytet apo bashki pa organizuar, për shembull, kemi Dhomën e Gjirokastrës që ka Tepelenën dhe Përmetin, por, duke qenë se Përmeti mund të ketë 3 avokatë, s'mund të krijojë dhomë. E rëndësishme është që, duke qenë në raport që numri është dinamik dhe lëviz, Dhoma herë pas here bën ekuilibra. Për shembull, Saranda më parë ka qenë e bashkuar me Gjirokastrën, pastaj u shtua numri dhe e veçuam më vete. Mund të ndryshojë harta gjyqësore, atëherë ne jemi të detyruar që këtë kompetencë ta ketë Këshilli i Përgjithshëm. Ndaj edhe kemi ndjekur këto...

Ulsi Manja – Zonja Hysi, pastaj zoti Çuçi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Pajtohem me shqetësimin e kolegut Fino, që Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë duhet të mbajë parasysh të dyja kriteret, edhe ndarjen e re territoriale administrative, edhe hartën gjyqësore, për aq sa është e mundur. Pse? Sepse në bazë të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”, çdo 5 vjet, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bashkëpunim me ministrinë, do të bëjë një studim dhe do të propozojë bashkim, ndarje, degëzime të gjykatave, por, duke qenë se ne do të shkojmë drejt gjykatave të mëdha që do të jenë më pak se ç'janë sot realisht, dhe kjo është e sigurt, ne nuk mund t'i lëmë qytetarët të mos marrin ndihmën juridike dytësore, pavarësisht se nuk është një gjykatë, të përpilojnë aktet etj.

Ndaj, do të sugjeroja që neni 28, paragrafi 2 të formulohet kështu: “Numri i dhomave vendore të avokatisë dhe shpërndarja territoriale e tyre në territorin e Republikës së

Shqipërisë të bëhet duke pasur parasysh numrin e avokatëve që bëjnë pjesë në to, ndarjen territoriale dhe për aq sa është e mundur edhe ndarjen...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sugjerim.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjala për zotin Çuçi.

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Në këtë rast nuk besoj se mund të aplikojmë ndarjen territoriale, por e shoh me vend që të përcaktojmë që dhomat vendore të avokatisë të organizohen sipas shtrirjes territoriale të gjykatave, të sistemit gjyqësor, dhe, nëse do t’i lëmë një diskrecion Dhomës së Përgjithshme të Avokatisë, në qoftë se është e mundur, mund të krijojë edhe dhoma të tjera jashtë kësaj ndarjeje. Pra, rregulli i përgjithshëm, për mendimin tim, do të isha kategorik sipas gjykatave dhe dhomave, pavarësisht se do të ketë një dhomë në Tepelenë, por edhe avokatët e Memaliajit do të jenë pjesë e Dhomës së Tepelenës dhe këtu nuk ka asgjë të keqe, apo në Përmet do të ketë dhomë, por edhe Këlcyra do të jetë pjesë e Dhomës së Avokatisë së Përmetit. Pra, nuk ka asgjë të keqe, që bashki të vogla mund të mund mos përfaqësohen me dhomë avokatie, se nuk ka ndonjë problem të madh, por për të ardhur në frymën liberale të dispozitës siç është shkruar, të përcaktojmë rregullin e përgjithshëm që organizohet sipas organizimit gjyqësor dhe pastaj t’ia lemë në çmim, në qoftë organizimi gjyqësor do të jetë shumë drastik dhe Dhoma e Përgjithshme e Avokatisë e sheh të nevojshme për organizim të brendshëm të krijojë dhoma të tjera, le ta miratojnë me vendim.

Unë do të mjaftohesha me organizimin gjyqësor dhe është krejt e arsyeshme.

Faleminderit!

Maksim Haxhia – Të nderuar deputetë!

Gjithë problemi i këtij neni është që ne i grupojmë avokatët jo thjesht nisur nga numri, por ka të bëjë me organizimin e tyre të brendshëm për shkak të trajnimit të tyre lokal, dhe kjo është kryesorja që na intereson, plus, edhe organizimi i brendshëm, sepse organet drejtuese të dhomave lokale menaxhojnë kryesisht avokatët dhe një sërë raportesh midis dhomës lokale dhe gjyqësorit vendor.

Kriteret në përcaktimin e numrit janë këto që thotë zoti Çuçi, harta administrative, harta gjyqësore, numri etj., që i mban dhoma kur përcakton...

Ulsi Manja – Fjala për zotin Hyseni.

Alket Hyseni – Zoti Haxhia, a do të ishte më mirë t'ia linim në kompetencë këshillit që të mos themi në statut, sepse ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në statut pastaj, doni e çoni, nuk doni s'e çoni. E di pse e them? Në momentin që ministria bën një organizim të ri, ti do të miratosh një numër të ri, le të themi, pra duhet të ndërrosh edhe statutin. Kjo nuk është e detyrueshme! Statuti është një, mund të rrijë aty dhe nuk ka lidhje me numrin e dhomave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ta hedhim në votim nenin 28?

Çfarë përkufizimi do të lëmë për pikën 3 përfundimisht, zoti Shameti?

Adnor Shameti – Sugjeroj që të hedhim në votim variantin e paraqitur të nenit 28 me sugjerimet e zonjës Hysi.

Bledar Çuçi – Propozoj që pika 3 të formulohet si më poshtë: “Numri i dhomave vendore të avokatisë dhe shpërndarja territoriale e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhet sipas organizimit të sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Në qoftë se lind nevoja apo shohim të arsyeshme të rregullojmë me ligj, me gjuhë, sipas... këshilli, dhe këtu ia lë të drejtën Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë, për miratimin edhe krijimin e dhomave të tjera.

I gjithë ky debat, pastaj, nëse do të duhet apo jo, do të bëhet në këshill sipas nevojave, qoftë trajnimi, qoftë të... rregulli është...

Adnor Shameti – “Jo më pak se aq sa ka gjykata” – thotë Çuçi...

(Diskutim i disa personave pa mikrofon)

Bledar Çuçi – Aty ku ka gjykatë, duhet të ketë dhomë avokatie. Ky është gjykimi im. Pikërisht këtu synoj. Ku ka gjykatë, duhet të ketë dhomë avokatie. Në qoftë se do të krijosh më shumë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa dhoma vendore janë sot?

Maksim Haxhia – Kemi 13 dhoma vendore.

Bledar Çuçi – Janë shumë më pak, atëherë.

Sa janë gjykata? 26.

Maksim Haxhia – Dhoma e Gjirokastrës, po marrim si shembull, ka Përmetin dhe Tepelenën. Avokatët e këtyre tri rretheve grupohen në dhomën e avokatisë lokale të Gjirokastrës.

Ulsi Manja – Nuk mendoj se janë shumë të rëndësishme këto gjëra. Organizimet e brendshme le t'i bëjë vetë dhoma. Se si organizohet dhoma në 13 zyra rajonale në 20 apo 30. Mua nuk më duken shumë të rëndësishme.

Alket Hyseni – Miratoje sipas propozimit që bëra unë. Përcaktoje në statut, por nga Këshilli.

Ulsi Manja – Jam dakord për sugjerimin, por nuk më duket se numri i dhomave vendore është ... Mund të jetë në diskrecionin e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë. E rëndësishme është të ofrohet ky shërbim te publiku.

Sot keni 13 dhoma, nesër mund të lindë nevoja t'i bëni 26 apo 30, ndaj është ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Çuçi.

Bledar Çuçi – Për zotin Haxhia: pse është problem të ketë 24 dhoma avokatie, për shembull, sa ka gjykata sot? Ka problem kostoje, menaxhimi apo çfarë? Unë, sinqerisht, mendoj se pranë çdo gjykate duhet të ketë një dhomë avokatie.

Maksim Haxhia – Nuk është problem menaxhimi, por, për shembull, Përmeti ka 1 kryetar dhe 2 avokatë. Do të krijojmë dhomë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Maksim Haxhia – Janë 3 gjithsej, e para.

E dyta, ne i kemi dhomat funksionale, sepse ata mbledhen dhe diskutojnë probleme juridike. Trajnimet i bëjmë në bazë lokale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tradita është ...

Bledar Çuçi – Pse ka gjykatë Përmeti?

(Diskutime pa mikrofon.)

Maksim Haxhia – Ka pas raste që ia keni hequr ju.

Alket Hyseni – Herë e ka pasur, herë nuk e ka pasur.

Ulsi Manja – Ju lutem!

Ta hedhim në votim nenin 28 me sugjerimin që bëhet për pikën 3? Fjalët “përcaktohen në statutin e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë” të zëvendësohen “vendosen nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë”?

Hedhim në votim nenin 28 të ligjit me sugjerimin e bërë nga kolegët për pikën 3. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Vasilika Hysi – Abstenim.

Ulsi Manja – Zonja Hysi është abstenim.

Miratohet neni 28.

Neni 29, “Organet drejtuese të Dhomave Vendore të Avokatisë”.

Adnor Shameti – Për nenin 29, “Organet drejtuese të Dhomave Vendore të Avokatisë”, kemi gjetur një gjuhë të përbashkët me të gjitha subjektet e interesuara, kështu që ju ftoj ta kalojmë siç është.

Ulsi Manja – Nga Dhoma janë dakord?

Maksim Haxhia – Dakord.

Ulsi Manja – Ministria është dakord?

Toni Gogu – Dakord.

Ulsi Manja - EURALIUS-i është dakord.

Hedhim në votim nenin 29, sipas variantit të propozuar në projektligj nga relatori, i dakordësuar në grupin e punës. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 29.

Vazhdojmë me nenin 30, “Mbledhja e përgjithshme e Dhomës Vendore të Avokatisë”.

Adnor Shameti – Për nenin 30, “Mbledhja e përgjithshme e Dhomës Vendore të Avokatisë” kemi gjetur mirëkuptimin e të gjitha subjekteve të interesuara, ndaj ju ftoj ta miratojmë me variantin që paraqitet.

Ulsi Manja – Dhoma është dakord.

Ministria?

Toni Gogu – Dakord.

Ulsi Manja – EURALIUS-i?

Dakord.

Hedhim në votim nenin 30, sipas variantit të propozuar në projektligj. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 30.

Vazhdojmë me nenin 31, “Kompetencat e mbledhjes së përgjithshme të Dhomës Vendore të Avokatisë”.

Adnor Shameti - Për nenin 31, “Kompetencat e mbledhjes së përgjithshme të Dhomës Vendore të Avokatisë”, kemi gjetur mirëkuptimin e subjekteve të interesuara, ndaj ju ftoj ta miratojmë siç paraqitet.

Ulsi Manja – Jeni dakord me nenin 31?

Maksim Haxhia – Dhoma është dakord.

Ulsi Manja - Dakord edhe nga Ministria e Drejtësisë.

Hedhim në votim nenin 31. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 31.

Kalojmë te neni 32, “Kompetencat e Komitetit Drejtues të Dhomës Vendore të Avokatisë”.

Adnor Shameti – Për nenin 32, “Kompetencat e Komitetit Drejtues të Dhomës Vendore të Avokatisë”, kemi gjetur mirëkuptimin e subjekteve të interesuara, ndaj ju ftoj ta miratojmë siç paraqitet.

Maksim Haxhia – Dhoma është dakord.

Ulsi Manja – Ministria është dakord?

EURALIUS-i?

Dakord.

Hedhim në votim nenin 32. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 32.

Kalojmë te kreu V, “Regjistrat e avokatëve”.

Neni 33, “Regjistrat e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë”.

Adnor Shameti – Për nenin 33, “Regjistrat e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë”, kemi gjetur mirëkuptimin e subjekteve të interesuara, ndaj ju ftoj të miratojmë variantin përfundimtar të paraqitur.

Maksim Haxhia – Dhoma është dakord.

Ulsi Manja – Ministria është dakord.

EURALIUS-i është dakord.

Hedhim në votim nenin 33. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 33.

Neni 34, “Regjistrat e Dhomës Vendore të Avokatisë”.

Adnor Shameti – Për nenin 34, “Regjistrat e Dhomës Vendore të Avokatisë”, kemi gjetur mirëkuptimin e subjekteve të interesuara. Në këto kushte, varianti i paraqitur është ai i dakordësuar dhe ju ftoj ta miratojmë.

Maksim Haxhia – Dhoma është dakord.

Ulsi Manja – Dhoma është dakord.

Ministria?

Toni Gogu – Ministria është dakord.

Ulsi Manja – EURALIUS-i?

Dakord.

Hedhim në votim nenin 34. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 34.

Neni 35, “Regjistri i kandidatëve për avokatë”.

Adnor Shameti – Për nenin 35, “Regjistri i kandidatëve për avokatë”, kemi gjetur dakordësinë e subjekteve të interesuara, ndaj ju ftoj ta miratojmë variantin përfundimtar të paraqitur.

Ulsi Manja – Zonja Hysi ka diçka për nenin 35.

Vasilika Hysi – Në nenin 35, këshilltarja e komisionit që po punon për këtë projektligj duhet të reflektojë amendamentin që ne kemi bërë për kartën personale të identitetit, terminologjinë.

Ulsi Manja – Faleminderit për sugjerimin, zonja Hysi!

Zoti Haxhia?

Maksim Haxhia – Dakord.

Ulsi Manja – Ministria?

Toni Gogu – Dakord.

Ulsi Manja – EURALIUS-i?

Korajlka Bumci – Dakord.

Ulsi Manja – Hedhim në votim nenin 35, me sugjerimin e koleges Hysi. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 35.

Kalojmë në nenin 36, “Dosja personale e kandidatit për avokat”.

Adnor Shameti – Për nenin 36, “Dosja personale e kandidatit për avokat”, kemi gjetur dakordësinë e subjekteve të interesuara, ndaj ju ftoj të miratojmë variantin përfundimtar të paraqitur para jush.

Ulsi Manja – Hedhim në votim nenin 36. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 36.

Kalojmë te kreu VI, “Procedimi disiplinor i avokatit”.

Neni 37, “Shkaqet për fillimin e procedimit disiplinor”.

Zoti Shameti, do t’ju lutesha, nëse nuk ka...

Adnor Shameti – Nuk ka ndryshime. Ju ftoj të miratojmë variantin e paraqitur.

Ulsi Manja – Dakord.

Zoti Haxhia?

Maksim Haxhia – Dakord.

Ulsi Manja – Ministria është dakord.

Zonja Hysi ka një sugjerim.

Vasilika Hysi – Në fakt, është problem i teknikës legjislative.

Te ligji ne nuk themi më “ndihma juridike falas”, por “ndihma juridike e garantuar nga shteti”. Flas për germën “c” të nenit 37. Do të ishte mirë ta ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja - Hedhim në votim nenin 37, me sugjerimin e koleges Hysi. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 37.

Kalojmë te neni 38, “Subjektet iniciuese të procedimit disiplinor”.

Adnor Shameti – Jemi dakord për miratimin e variantit të paraqitur.

Maksim Haxhia – Dhoma është dakord.

Ulsi Manja – Ministria?

Toni Gogu – Dakord.

Ulsi Manja – EURALIUS-i?

Korajlka Bumci – Dakord.

Ulsi Manja – Ka sugjerime nga kolegët? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 38. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 38.

Kalojmë te neni 39, “Depozitimi i ankesave”.

Adnor Shameti – Nuk ka ndryshime. Jemi dakord për variantin e paraqitur.

Maksim Haxhia – Dhoma është dakord.

Ulsi Manja – Ministria?

Toni Gogu – Dakord.

Ulsi Manja – EURALIUS-i?

Korajlka Bumci – Dakord.

Ulsi Manja – Hedhim në votim nenin 39. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 39.

Kalojmë te neni 40, “Komisioneri i ankimeve”.

Adnor Shameti – Kërkojmë miratimin e variantit të dakordësuar, sipas variantit të paraqitur.

Maksim Haxhia – Dhoma është dakord.

Ulsi Manja – Ministria?

Toni Gogu – Dakord.

Ulsi Manja – EURALIUS-i?

Korajlka Bumci – Dakord.

Ulsi Manja – Hedhim në votim nenin 40. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 40.

Kalojmë te neni 41, “Përbërja, kompetencat dhe vendimmarrja e Komitetit Disiplinor”.

Adnor Shameti – Për nenin 41 kërkojmë të miratohet varianti i dakordësuar pa ndryshime.

Maksim Haxhia – Dhoma është dakord.

Ulsi Manja – Ministria?

Toni Gogu – Jemi dakord me synimin që anëtarët e KLGJ-së dhe të KLP-së ndoshta kanë nevojë për një rregullim kalimtar, që Dhoma të vazhdojë funksionimin deri sa ata të zgjidhen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në pikën 2 thuhet: “Komiteti Disiplinor përbëhet: germa “b”: “një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor; një përfaqësues i Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Deri në ngritjen e këtyre institucioneve, do të vazhdojë funksionimi siç është.

Dakord, qëndron sugjerimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund ta lëmë edhe me dispozitë transitore në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Të mbahet shënim, që ta rregullojmë në fund si dispozitë transitore.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Unë jam dakord me pikat që kanë vënë, 7 anëtarë, komiteti drejtues, por nuk e kuptoj “një përfaqësues i shoqërisë civile ose i botës akademike në fushën e drejtësisë”. Pse duhet ky? Jam dakord për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Ministrinë e Drejtësisë e me radhë, po përfaqësuesi i shoqërisë civile ose i botës akademike pse duhet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne i vlerësojmë më shumë se ç’duhet këta dhe më pas e dimë se çfarë ndodh. Pyes kryetarin e Dhomës. Çfarë jep ky më tepër se këta të tjerët që janë më kompetentë dhe janë ...

Maksim Haxhia – Zoti Fino, në dy mandatet e Komitetit Disiplinor i kemi zgjedhur nga bota akademike.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Kam një merak.

Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë i kanë kompetencat e parashikuara me një ligj të miratuar me 84 vota. A mundemi ne, me një ligj të thjeshtë, t’u caktojmë kompetenca sa herë të na teket?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si e mendoni ju Këshillin e Lartë Gjyqësor? Do të shkojë në çdo procedim disiplinor, por mund të jenë edhe me qindra ato.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk mund të flasim kështu, sepse është organ kushtetues, zotëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një organ kushtetues duhet të caktojë një përfaqësues te Komiteti Disiplinor i një ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne po bëjmë disa sofizma.

Më lejoni!

Unë jam pak i ashpër, por ne po bëjmë tejkalime, shpikje vetëm shqiptare. Lëreni Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë të bëjë atë që është qëllimi i reformës zgjedhore. Lërin këto dy organe të merren me gjyqtarët dhe prokurorët. Nëse bëjnë atë detyrë, i kanë bërë të gjitha. Për avokatët të gjejme mekanizma të tjerë për t’i rregulluar ...

Do bëjmë qoka ne, Maksi? Ne ofendojmë Këshillin e Lartë Gjyqësor kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë propozoj të mos ketë ...

E mbështes zotin Fino. Nuk mund të ketë në Komunitet Disiplinor një organ ekzekutiv të nivelit të ulët, përfaqësi nga organe serioze, siç janë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Nëse doni të gjejmë një mekanizëm tjetër... Si mundet që një anëtar i tyre të shkojë këtu? Të njëjtën gjë kishim edhe në ligjin “Për Policinë Gjyqësore”, kemi bërë diskutime, e kemi parë me vëmendje. Kompetencat e këtyre organeve nuk mund të tejkalohen me ligje të zakonshme.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Zoti Haxhia.

Maksim Haxhia – Ne kemi ruajtur reciprocitetin. Ka avokat në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe avokat në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Këtu nuk thuhet “një anëtar i Këshillit të Lartë të Gjyqësorit”. Mund të jetë apo mund të mos jetë anëtar. Ne themi “një përfaqësues”, që zgjidh problematikën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Përfundimisht, pasi i dëgjova me vëmendje të gjitha sugjerimet, insistoj të kalojmë variantin e paraqitur, pasi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, të mbaroj!

Pjesëmarrja e një përfaqësuesi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Hyseni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adnor Shameti - Pjesëmarrja e detyrueshme e një përfaqësuesi të KLP-së apo KLGJ-së garanton në mënyrë të drejtpërdrejtë uniformitetin në organet e drejtësisë dhe zgjidhjen e të gjitha problematikave që kemi ndeshur e kemi hasur deri më sot, që të gjithë anatemojnë avokatinë. Duke qenë vet përfaqësues i KLP-së dhe KLGJ-së në këtë organ për marrjen e masave disiplinore, na garantoni të mos kemi përsëritje në të ardhmen të të gjitha problematikave për përfaqësimin e avokatëve në proceset gjyqësore.

Ulsi Manja – Zoti Çuçi.

Bledar Çuçi - Faleminderit!

Duhet të sqarojmë një gjë. Marr shkas edhe nga ajo që tha zoti Haxhia, në lidhje me faktin nëse është anëtar i këshillit apo jo anëtar. Tani, edhe për interpretim të dispozitës, që

do të na duhet nesër pasnesër, domethënë, nga hartuesit e dispozitës është marrë parasysh se kur themi një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor, do të thotë që mund të mos jetë anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, a mund ta sqarojmë dhe të themi: “një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor jo anëtar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse shqetësimi i Alketit është i drejtë deri diku.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Çuçi, ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” e shpreh në mënyrë të qartë kur flet për kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe e Këshillit të Lartë të Prokurorisë: “si dhe kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj”.

Kjo do të thotë se edhe në ligjin “Për avokatinë”.

Bledar Çuçi – Me ligj, por...

Ulsi Manja – Me ligj, se s’jemi duke e bërë me VKM.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thotë, e ka të hapur atje. E njëjta situatë po diskutohet edhe në lidhje me ligjin “Për Policinë Gjyqësore”.

Bledar Çuçi – Një minutë, një minutë...

Ulsi Manja – Më fal pak, t’ju sqaroj pak përbërjen e KLP-së dhe KLGJ-së. Funkcionojnë disa komitete në kundër të KLP-së e KLGJ-së.

Bledar Çuçi – Që anëtarët e KLGJ-së janë komisionet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Të lutem!

Ka një sugjerim nga zoti Çuçi për të sqaruar çështjen nëse një përfaqësues i Këshillit të Lartë gjyqësor do të jetë anëtar apo mund të jetë edhe përfaqësues tjetër.

Bledar Çuçi – Kjo është shumë e rëndësishme.

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Lidhur me kandidatin për në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë do të doja të sillja në vëmendje nenet e Kushtetutës që bëjnë fjalë për funksionet që ushtron Këshilli i Lartë Gjyqësor. Është neni 147 “a”. Të njëjtën gjë replikoj edhe për Këshillin e lartë të Prokurorisë, por nuk dua ta përsëris.

Është e vërtetë ajo që thoni ju, zoti kryetar, se Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron kompetenca që ia jep Kushtetuta, dhe në shkronjën “ë” të paragrafit të parë: “dhe ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj”.

Kur thuhet “me ligj”, është ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Këtu i jap të drejtë zotit Çuçi.

Çfarë thotë ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe shqetësimi që ngriti Alketi. Në rast se shkojmë te kompetencat që i janë dhënë funksioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përmenden kompetenca të tjera, si: planifikimi strategjik; raportimi në publik dhe para Kuvendit; etika gjyqësore; përcaktimi i kompetencave territoriale...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, kolegë...

Ulsi Manja – Ju lutem!

Vasilika Hysi – Përcaktimi i kompetencave territoriale dhe madhësia e gjykatave; rekrutimi dhe emërimi i kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën e lartë; zhvillimi i karrierës dhe disiplina për gjyqtarët, ose respektivisht për prokurorët, kur bëhet fjalë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë; trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve.

Pra, asnjëherë nuk thotë se ky këshill, qoftë Këshillit i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë, do të merret me punë administrative me Komitetin Disiplinor.

E treta dhe e fundit: ajo që tha kolegu Haxhia: në Këshillin e Lartë të Prokurorisë apo në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka përfaqësues nga avokatia.

Po, është e vërtetë: ka përfaqësues nga avokatia, po kur kemi bërë debat në lidhje me përbërjen e anëtarëve jo gjyqtarë dhe jo prokurorë në këto këshilla, ne thamë: ata nuk përfaqësojnë Dhomën e Avokatisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për shkak të profesionit, jo. Do të jenë avokatë, që të kenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk janë përfaqësuesit tuaj. Në këtë kuadër, nuk është e thënë se, meqenëse ju keni avokatë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për reciprocitet duhet të kenë edhe ata. Kjo logjikë nuk është. Unë besoj se është shumë e sforcuar përfshirja e anëtarëve të Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Zoti Hyseni, po prandaj funksionon vota këtu në komision. Është e thjeshtë gjëja. Marrim propozimet, për ekonomi kohe. Ka një propozim që të mos jetë, ka një propozim që të jetë si teksti. Marrim edhe mendimin e dhomës, të ministrisë e të EURALIUS-it.

Dhoma, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Maksim Haxhia – Zoti kryetar, fakti që kemi bërë këtë formulim do të thotë se dhoma, në problemin e saj më nevralgjik, që është procedimi disiplinor, i cili ka qenë problem edhe për opinionin, fut përfaqësues nga institucionet e tjera, për t'i dhënë një frymë kontrolli. Sa na takon neve, ne kemi cenuar veten kur kemi pranuar të tillë përfaqësues, por kjo është në të mirën e punës. Jemi tre institucione, të cilat punojmë e koepojmë me njëri-tjetrin dhe jemi në bashkëpunim gjithë ditën. Në fund të fundit, kjo ka të bëjë me etikën profesionale dhe etikën e sjelljes para institucioneve e para klientit.

Ju vendoseni si të doni.

Ulsi Manja – Misioni EURALIUS.

Korajlka Bumci – Nuk kam opinion në lidhje me këtë.

Ulsi Manja – URALIUS s'ka opinion.

Ministria e Drejtësisë.

Toni Gogu – Për ne si Ministri e Drejtësisë disiplinimi është një element, është një moment shumë i rëndësishëm në jetën profesionale të avokatit, kështu që mendojmë se prania e përfaqësuesve të gjyqësorit dhe përfaqësuesve të prokurorisë në një komitet disiplinor është jashtëzakonisht e rëndësishme.

Nëse do t'i marrim nga organet kushtetuese, siç është Këshilli i Lartë Gjyqësor, gjë për të cilën jemi plotësisht dakord, apo do t'i marrim nga organizimet vullnetare, siç janë shoqatat përkatëse, kjo është një çështje që mund ta çmoni.

Ulsi Manja – Si do ta lëmë për nenin 41? Sepse, zoti kryetar i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, për t'ua bërë qejfin kot e ke futur. Mund të ishe shumë i lirë të vendosnit si të donit në Komitetin Disiplinor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse kolegët e mi do të duan ta riformulojnë pikën 2 të nenit 41, unë e shtyj votimin e nenit 41. Hiqeni po të doni, bini rehat, lini vetëm Ministrinë e Drejtësisë e dhomën, dhe keni një Komitet Disipline të mrekullueshëm. Doni këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E shtyjmë nenin 41; kalojmë te neni 42.

Alket Hyseni – Ka një propozim nga Çuçi, pra.

Ulsi Manja – Cili është propozimi?

Alket Hyseni – Çuçi e ruajti këtë, duke shtuar: “një përfaqësues jo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Ulsi Manja – Po mund të dojë të shkojë anëtari.

Alket Hyseni – Po nuk shkon dot. Më lejoni t’ju sqaroj. Ne nuk mund të ndajmë me votë këtu një gjë antikushtetuese. Ajo që është antikushtetuese, është antikushtetuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Nuk e zgjidhim unë e ti këtë çështjen e antikushtetutshmërisë. E zgjidh Gjykata Kushtetuese. Kjo çështja e antikushtetutshmërisë është e mbyllur në drejtësi. E vendos Gjykata Kushtetuese.

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Megjithëse u bë debat i madh, unë mendoj se shtatë anëtarë janë, njëherë, se e ka pika e dytë. Heqim gjyqësorin, prokurorinë, lëmë një nga Ministria e Drejtësisë dhe një nga akademia në Fushën e Drejtësisë. Këta të jenë si komision, dhe ta mbyllim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Numër tek pra: shtatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shtatë, tetë, nëntë. Bëhen 9. Shtatë janë, një është përfaqësues i ministrisë, një është nga akademia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me nëntë vetë.

Shtatë janë. Një nga Ministria e Drejtësisë, një nga akademia, bëjnë nëntë vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Heqim germat “b” dhe “c” dhe lëmë të tjerat, duke thënë: “Nga Ministria e Drejtësisë dhe nga bota akademike në fushën e drejtësisë”.

Ulsi Manja - Pra, ka një propozim për të hequr germat “b” dhe “c” nga pika 2 e nenit 41. Ky është propozimi? Që të jem korrekt, se do ta hedh në votim.

Ju lutem: ka një propozim nga zoti Fino, që pika “b” dhe pika “c” e nenit 41, paragrafi 2, të hiqen. E hedhim në votim propozimin.

Kush është pro heqjes së pikave “b” dhe “c” nga paragrafi i dytë i nenit 41? Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se do të numëroj votat. Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, a ka mundësi, se e kam hedhur në votim?

Kush është pro? Të ngrejë dorën kush është pro heqjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që të hiqen pikat “b” dhe “c” nga paragrafi i dytë i nenit 41. Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, janë sqaruar mirë ata. janë sqaruar që ç’ke me të. Të merret një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë dhe një i botës akademike ose i shoqërisë civile. E kam hedhur në votim.

Kush është pro propozimit të zotit Fino?

Një, dy, tre. Nuk miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është kundër propozimit të zotit Fino?

Abstenim?

Nuk fiton propozimi i zotit Fino.

Hedhim në votim nenin 41, sipas variantit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cili?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hedhim në votime dhe propozimin e zotit Çuçi, që të jetë një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor, por jo anëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S’e di unë. E hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Unë hedh në votim propozimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht, pra: anëtari mund të shkojë, se pengon askush.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta hedhim në votim edhe propozimin e zotit Çuçi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Çuçi, ta hedhim në votim propozimin?

Ka edhe një propozim nga zoti Çuçi, sipas të cilit pika “b” dhe pika “c” të riformulohen: një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor jo anëtar dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë të Prokurorisë jo anëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, kush është pro propozimit të zotit Çuçi?

Dy pro. Bie propozimi i zotit Çuçi. Nuk miratohet.

Hedhim në votim nenin 41, sipas variantit të propozuar nga relatori dhe i dakordësuar në grupin e punës.

Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka vërejtje për pikat e tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Bie dakord me këtë që votuat ju. Kam dy gjëra: e para, njëherë, propozova që përfaqësuesi të jetë nga Akademia e Drejtësisë. E dyta që propozoj është kjo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Mund të vazhdoni, zoti Fino.

Bashkim Fino – Pse kryetari i Komisionit të Disiplinës duhet të ketë mandat dyvjeçar dhe jo katërvjeçar? Se tani, ju e vini me mandat dyvjeçar kryetarin e Komisionit të Disiplinës, kryetarin e avokatisë e vini me mandat katërvjeçar. Vërinë të dy njësoj. Merrni një kryetar avokatie për katër vjet, merrni edhe një kryetar të Komisionit të Disiplinës katër vjet. Pse dy vjet? Ndërkohë, anëtarëve, te ky neni këtu poshtë, ua keni bërë katër vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anëtarët katër vjet, kryetari dy. Pse e keni bërë dy? Pse s’e keni bërë pesë, katër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ju lutem!

Zoti Fino, do të merremi vesh apo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Haxhia, një përgjigje për pyetjen e zotit Fino.

Maksim Haxhia – Zoti Fino ka të drejtë, sepse në variantin e parë, që është ndryshuar, afati i Komitetit Disiplinor ka qenë pesë vjet. Meqë afati është katër vjet, për mua merr sens të unifikohet dhe kjo.

Ulsi Manja – Ta bëjmë pesë vjet?

Maksim Haxhia – Katër vjet.

Ulsi Manja – Katër vjet. dakord!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Tani hedhim në votim nenin 41, me sugjerimin e zotit Fino në lidhje me pikën 3 të nenit 41. Kush është pro me nenin 41, sipas variantit që propozohet me sugjerimin e zotit Fino? Kush është pro? Ngrini duart. Pra, për nenin 41, sipas variantit që propozohet me sugjerimin e zotit Fino në lidhje me pikën 3, që mandati unifikohet katër vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për nenin 41, pikën 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozimi i Finos ra. Propozimi i Çuçit ra. Ka një sugjerim të zotit Fino për pikën 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk votohet me pika neni.

Kush është dakord me nenin 41, me sugjerimin e bërë nga zoti Fino për pikën 3?

Pro? Kundër? Kush është kundër? S’ka. Abstenim? Abstenime 3.

Miratohet neni 41.

Kalojmë te neni 42.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Hyseni, kemi tre orë këtu...

Alket Hyseni – Dua të sqaroj votën.

Ulsi Manja – Sqaroje votën, se s’është problem. Abstenimi nuk sqarohet.

Alket Hyseni – Së bashku me kolegun Çuçi, ne ngritëm një shqetësim, i cili është kushtetues dhe parimor. Nuk jemi kundër, prandaj abstenuam dhe nuk votuam kundër. Nuk jemi kundër çdo forme organizimi, por jemi kundër parimit që të kemi një ligj të çfarëdoshëm, t’u japim detyrim organeve kushtetuese të ngritura me një mision tjetër që të caktojnë një përfaqësues “nga ta doni”, thuhet këtu. Po si more? Si mund të jetë që një organ kushtetues të zgjedhë një anëtar nga rruga që të jetë përfaqësues i tij. Lodra po bëjmë këtu?

Organet kushtetuese, ose përfaqësohen nga anëtarët e tyre, ose nuk përfaqësohen fare.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni për sqarimin e votës!

Secili ka mendimin e vet, që e manifeston me votë.

Vazhdojmë me nenin 42 “Parimet e procedimit disiplinor”.

Adnor Shameti – Ky nen është i dakordësuar me subjektet e interesuara. Në këto kushte ju ftoj të miratojmë variantin e paraqitur.

Ulsi Manja – Dhoma, për nenin 42?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Kush është pro nenit 42? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 43 “Masat disiplinore”.

Adnor Shameti – Ky nen është i dakordësuar me subjektet e interesuara. Në këto kushte ju ftoj të miratojmë variantin e paraqitur.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Më vjen mirë që masat disiplinore detajohen sipas natyrës, por ju thoni sipas rëndësisë. E keni fjalën të rrezikshmërisë, të rëndësës së tyre?

Unë them që çdo shkelje disiplinore ka rëndësi të trajtohet e të ketë një masë disiplinore, po këtu po flasim për shkallën e rëndësës së tyre, jo të rëndësisë. Duhet ta rregullojmë fjalën...

Ulsi Manja – Ju lutem, çfarë mendon Dhoma në lidhje me pikën 1 të nenit 43: “Masat disiplinore jepen bazuar në natyrën dhe rëndësinë e shkeljes”!

Maksim Haxhia – Për ne është e qartë.

Ulsi Manja – Relatori?

Adnor Shameti – Dakord me variantin e paraqitur?

Ulsi Manja – A ka sugjerime të tjera për nenin 43?

E hedhim në votim, sipas variantit që paraqitet.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 44 “Heqja e titullit dhe pezullimi i lejes së ushtrimit të profesionit”.

Burrë – Kërkojmë miratimin e variantit të paraqitur, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Kush është pro nenit 44, sipas variantit të paraqitur? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet neni 44.

Neni 45 “Masat e tjera dhe shpenzimet”

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit të paraqitur, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet neni 45.

Neni 46 “Regjistrimi dhe publikimi i masave disiplinore”.

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet neni 46.

Neni 47 “Shuarja e masave disiplinore”.

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet neni 47.

Neni 48 “E drejta e ankimit”.

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet neni 48.

Neni 49 “Gjykata kompetente”

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Për nenin 49 unë mendoj se paragrafi i dytë i nenit është i tepërt dhe nuk ka pse qëndron, sepse paragrafi i parë flet se cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve. Janë konsideruar mosmarrëveshje të natyrës administrative, kompetente është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë.

Paragrafi i dytë i nenit flet se çfarë ligji zbaton gjykata kur merr në shqyrtim çështjen. Është e panevojshme të shkruhet në tekst të nenit, kështu që unë mendoj të shihet pika 2 e nenit 49 dhe të ngelet vetëm me paragrafin e pikës 1.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Relatori?

Dakord.

Kush është dakord me nenin 49 me propozimin që të hiqet paragrafi i dytë dhe të ngelet vetëm paragrafi i parë?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet neni 49.

(Diskutime pa mikrofon)

Ne kemi dhënë prova në këtë komision se opozitën e trajtojmë më mirë se pozitën, por na shpëtoi sot.

Kërkoj ndjesë, zoti Fino!

Vazhdojmë me Kreun VII “Edukimi profesional i avokatit”.

Neni 50 “Sistemi i trajtimit profesional”

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet neni 50.

Neni 51 “Trajnimi fillestar”.

Burrë - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet neni 51.

Neni 52 “Trajnimi i vazhdues”.

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 52.

Neni 53 “Shkolla e Avokatisë”.

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 53.

Neni 54 “Rregullorja e Shkollës së Avokatisë”.

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Adnor Shameti – Në vazhdim të sugjerimeve të kolegëve do të sugjeroja eliminimin e nenit 54 dhe kalimin si paragrafi i tretë. Nuk ndryshon përmbajtja, duke qenë se jemi te shkolla dhe rregullorja, mos ta lëmë kaq të thatë. Të jetë thjesht si paragraf i tretë i nenit 53.

Ulsi Manja – Ka një sugjerim, një propozim të relatorit që neni 54 të kalojë si pikë e tretë e nenit 53.

A jeni dakord?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kalojmë te Kreu VIII “Dispozitat kalimtare dhe të fundit”.

Neni 55, që bëhet neni 54 “Dispozitat kalimtare”.

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, lidhur me nenin 54, ju thoni në paragrafin e parë që mandati i organeve drejtuese të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe Dhomës Vendore të Avokatisë është mandat vazhdues deri në përfundim.... Pra, kjo duhet të qartësohet.

Pyetja e dytë është lidhur me përfshirjen e provimit të shtetit. Çfarë qëndrimi do të mbajmë lidhur me provimin shtetit, për kandidatët që do të hyjmë më pas në Avokati.

Ulsi Manja – Zonja Hysi, për këtë pyetjen e dytë e keni shënimin që kemi bërë, se ju nuk keni qenë në diskutimet e neneve të para. Janë 3-4 nene të hapura dhe një ndër këto është edhe neni 11, i cili do të diskutohet se nuk do ta votojmë në tërësi projektligjin sot.

Urdhëroni, zoti Haxhia!

Maksim Haxhia – Këtu jemi dakord, vetëm me atë shtesën për dispozitat.

Ulsi Manja – Neni 55, që bëhet neni 54.

Korajlka Bumci –(për~~kthen~~ për~~kthyesja~~) Kjo të mbetet e hapur derisa të mbarojnë edhe të tjerat.

Ulsi Manja – Neni 55 ngelet i hapur për t’u parë bashkë me 3-4 nenet e tjera që i kemi lënë të hapura.

Neni 56 “Aktet nënligjore”.

Adnor Shameti - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Zoti Haxhia, në pikën e dytë keni thënë: “Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji merr masa për ndryshimin e statutit, si dhe miratimin e akteve nënligjore në përputhje me parashikimet e këtij ligji”.

Ministri i Drejtësisë dhe kryetari i Dhomës së Avokatisë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji nxjerrin aktet nënligjore në zbatim në nenit 14 të këtij ligji...

Maksim Haxhia – I unifikojmë në 6 muaj të dy.

Ulsi Manja – Pra, kërkoni të unifikoni në 6 muaj paragrafin e parë dhe të dytë.

Dakord.

Hedhim në votim nenin 56 me unifikimin e afatit 6-mujor.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 57 “Shfuqizime”.

Burrë - Kërkojmë miratimin e variantit përfundimtar, pasi është i dakordësuar nga të gjithë subjektet e interesuara.

Ulsi Manja – Dhoma?

Dakord.

Ministria?

Dakord.

EURALIUS-i?

Dakord.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 57.

Neni 58 “Hyrja në fuqi”.

Burrë – Dakord me variantin përfundimtar.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet neni 58.

Faleminderit!

Nuk do ta votojmë sot në tërësi, pasi kemi lënë disa nene të hapura, të cilat do të dakordësohen nga relatori, Dhoma, Ministria dhe EURALIS-i.

Këshilltarët e komisionit kanë mbajtur shënim nenet për të cilat është lënë i hapur diskutimi dhe miratimi nen për nen, kështu që në mbledhjen e radhës mbyllim edhe nenet e lëna hapur pastaj bëjmë votimin në tërësi të projektligjit “Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë”.

E mbyllim këtë pikë të rendit të ditës për sot.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

4. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Spartak Braho, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Nasip Naço, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Silva Caka, Tom Doshi.

Të ftuar:

Toni Gogu, Zëvendësministër i Drejtësisë
Ardian Shega, Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit
Sokol Sadushi, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës
Z. Jonn Smibert, Këshilltar Ligjor Rezident, OPDAT
Znj. Armanda Sellaj, përkthyesë
Znj. Agnes Bernhard, Shefe e Misionit “EURALIUS”
Z. Chuck Ericksen, Këshilltar i Lartë, USAID
Znj. Lisina Mano, përkthyesë

Ulsi Manja - Në fakt, si pikë e tretë e rendit të ditës i bie “Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017”, por duke qenë se mbledhja zgjati përtej parashikimeve, propozoj që pikën 3 ta bëjmë pikë 4 dhe pikën 4 ta bëjmë 3, pra shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96 të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që është nismë deputetësh.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Adnor Shameti.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen në komision: nga Ministria e Drejtësisë, zoti Toni Gogu, zëvendësministër, zoti Ardian Shega, drejtor i Përgjithshëm; nga Shkolla e Magjistraturës, zoti Sokol Sadushi, drejtor i Shkollës së Magjistraturës; nga OPDAT-i, John Smibert, këshilltar ligjor dhe zonja Armanda Sellaj, përkthyesë; nga misioni ndërkombëtar EURALIUS, Agnes Bernhard, shefe e Misionit dhe nga USAID-i zoti Chuck Ericksen, këshilltar i lartë dhe Lisina Mano, përkthyesë.

Ju lutem, zini vendet!

Është një projektligj që ka ardhur si propozim i dy deputetëve, imi, si kryetar i komisionit, dhe i koleges Bushka, për një ndryshim në ligjin nr. 96 të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht, kërkohet të bëhen ndryshime në dy nene të këtij ligji, që u referohet dispozitave kalimtare. Në fakt, është neni 160 i këtij ligji, i cili ka të bëjë me emërimin e kandidatëve që diplomohen në Shkollën e Magjistraturës dhe në nenin 170, pika “a”, kërkohet të shtohet një pikë 3 me përmbajtjen që ju e keni mbi tavolinë, por që do ta prezantojë kolegja Bushka, e cila ka lidhje me kuotat e pranimit në Shkollën e Magjistraturës dhe kohën e zhvillimit të konkursit. I kërkoj koleges Bushka të bëjë shkurtimisht prezantimin e kësaj nisme. Jemi dy kolegë, por mund të ishin të gjithë kolegët e Komisionit të Ligjeve. Për efekt procedural, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, pra për të fituar kohë që ta futim në kalendarin e punimeve të Kuvendit, ishte propozimi im dhe i koleges Bushka. Zonja Bushka, të lutem shkurtimisht, prezantoje propozimin!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ky propozim ka në thelb të tij disa ndryshime në ligjin nr. 96 të vitit 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Është një nismë që, në fakt, adreson dy probleme: i pari ka të bëjë me emërimin e atyre magjistratëve, të cilët kanë mbaruar të gjithë ciklin e studimeve dhe praktikën në Shkollën e Magjistraturës dhe

duhet të emërohen në vitin 2018 në pozicionet përkatëse; tjetri ka të bëjë me çështjen e rekrutimeve, me numrin e atyre kandidatëve për magjistratë që duhen rekrutuar për vitin 2018-2019 dhe për vitin 2019-2020.

Pse kanë lindur problemet?! Problemet kanë lindur, sepse në ligjet aktuale, që kanë ardhur si pasojë e zbatimit të ndryshimeve kushtetuese për reformën në drejtësi, detyrat për të dyja çështjet që shtrova më sipër kryhen në bashkëveprim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Të dyja këto organe nuk janë ngritur ende. Duke qenë se organet nuk janë ngritur ende për shkak se çështja e vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që janë kandidatë për të dy këshillat, nuk ka mbaruar dhe jemi sot ende në procesin e vetingut të këtyre kandidatëve, ata nuk mund t'i ushtrojnë kompetencat e tyre për sa i takon emërimin të magjistratëve që diplomohen dhe që duhen emëruar në vitin 2018. Në të njëjtën kohë, këta dy këshilla kanë kompetencën e tyre që të përcaktojnë edhe numrin e kandidatëve për magjistratë si për gjyqësorin, edhe për prokurorinë në vitet 2018-2018 e më tutje.

Për të adresuar këto dy shqetësime është e nevojshme që ne të bëjmë një rregullim të ligji "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Detyrat që u ngarkohen nga ligjet aktuale KLGJ-së dhe KLP-së t'i parashikojmë direkt në këtë ligj, në mënyrë që t'i japim mundësi Shkollës së Magjistraturës të organizojë në kohë konkursin, sepse flasim edhe për procedura që kanë kohë të përcaktuara, duke pasur parasysh vitet akademike dhe proceset që i paraprijnë rekrutimit të kandidatëve për magjistratë. Kështu, bëhet fjalë që të paktën në tetor, në mos gabor, duhet të kemi kryer patjetër procesin, pra Shkolla e Magjistraturës duhet t'i ketë rekrutuar kandidatët e rinj për vitin 2018-2019 e në vijim.

Ndërsa për sa u takon atyre, që janë tashmë kontingjent për emërim në gjyqësor dhe në prokurori (flas për ata që kanë përfunduar ciklin e studimeve të Magjistraturës dhe që duhet të emërohen në vitin 2018), edhe kjo duhet të gjejë një rregullim në ligj për sa i takon faktit se ku do të emërohen dhe si do të emërohen. Kështu që, me pak fjalë, ky është qëllimi i projektaktit që ne paraqesim, i cili është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të mbushur dy boshllëqet që ju kam paraqitur.

Sigurisht, ne jemi konsultuar edhe me Shkollën e Magjistraturës, e cila ka dhënë një kontribut në këtë nismë, me misionin e EURALIUS-it, si dhe me misionin e OPDAT-it, të cilat kanë qenë pjesë e konsultimeve tona, në mënyrë që të kemi tashmë një propozim të konsoliduar. Kjo është vetëm një nismë. Ne jemi ta hapur për sugjerime, pra nëse ka nevojë

ta përmirësojmë apo ta ndryshojmë draftin. Ky ishte thjesht veprimi ynë i parë për ta nisur si proces dhe për të mos e vonuar më.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjalën e ka zoti Shameti, si relator i këtij projektligji.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të bëj me dije komisionin se projektligji ka si qëllim rregullimin e situatës aktuale në sistemin aktual të drejtësisë, për shkak të moskonstituimit të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, në veçanti të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sikurse e paraqiti pak më sipër kolegja Bushka.

Shkolla e Magjistraturës aktualisht ndodhet në pamundësinë e organizimit të provimit të pranimit për kandidatët për magjistratë, por edhe të mosemërimit të kandidatëve për magjistratë, të cilët diplomohen në muajin qershor të vitit 2018. Për sa më sipër, ne propozojmë shtesën në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorë në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vazhdimin e funksionimit normal të Shkollës së Magjistraturës dhe realizimin e objektivave që ka ky institucion për t’iu përgjigjur kërkesave që ka sistemi i drejtësisë. Në këto kushte, kërkoj dhe vlerësoj rëndësinë e miratimit të ndryshimit të sipërpërmendur në ligjin organik dhe kërkoj mbështetjen nga të gjithë anëtarët e komisionit për miratimin e kësaj nisme.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Shfrytëzojmë rastin që sot në mbledhjen e komisionit kemi edhe drejtorin e Shkollës së Magjistraturës, edhe zëvendësministrin e Drejtësisë, si edhe dy përfaqësuesit e dy misionëve të rëndësishme, të cilët asistojnë procesin e reformës në drejtësi, EURALIUS-in dhe OPDAT-in.

Zoti Sadushi, ju lutem, shkurtimisht, dua opinionin tuaj lidhur me nismën. A qëndrojnë dy problemet, të cilat unë dhe zonja Bushka i kemi materializuar në këtë nismë?

Sokol Sadushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, të nderuar deputetë!

Unë e vlerësoj nismën që ju keni marrë, sepse, në fakt, lidhet me misionin që ka Shkolla dhe me kolapsin që mund të ketë ajo për shkak të mosemërimit të kandidatëve për magjistratë, të cilët diplomohen më 30 qershor të këtij viti, janë rreth 16 të tillë, ashtu siç ka

të bëjë edhe me mospërcaktimin e kuotave për konkurrimin, pra me procesin e rekrutimit të kandidatëve për magistratë për vitin 2018-2019.

Në fakt, nga viti 2016, kur është miratuar ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorë në Republikën e Shqipërisë” dhe të gjitha ligjet e tjera të reformës, kjo gjë është zgjidhur me ligj, pra qoftë diplomimi i kandidatëve magistratë në vitin 2016, sepse në vitin 2017 Shkolla nuk kishte kandidatë, sepse ishte një vit bosh, qoftë përcaktimi i kuotave janë bërë me ligj. Janë përcaktuar dy vite akademike, viti 2016-2017 dhe viti 2018-2019. Tashmë jemi në vitin akademik 2018-2019. Bllokimi, që është krijuar për shkak të mosngritjes së KLGJ-së dhe KLP-së, e ka krijuar këtë pengesë për Shkollën, sepse kuotat i përcaktojnë vetëm këto dy organe, sipas ligjit të ri për statusin e gjyqtari dhe prokurorit, dhe emërimi i tyre bëhet nga KLGJ-ja dhe KLP-ja.

Ne jemi plotësisht dakord me propozimin e bërë, duke pasur parasysh edhe kapacitetet që ka Shkolla, që lidhet me rekrutimin e kandidatëve të rinj për magistratë, sipas variantit që ju keni propozuar. Sidoqoftë, Shkolla ka një hapësirë për kandidatë që mendohet të vijnë në tetor, të cilët janë nga radhët e këshilltarëve ligjore që kaluan një testim *ex officio* për shkak të ligjit të ri të rivlerësimit kalimtar, por numri i atyre që ka kaluar këtë prag, dhe është në dorë të tyre hyrja ose jo në Shkollë, është i vogël, jo më shumë se 10. Pra, në tetor Shkolla e Magjistraturës nuk mund të ketë më tepër se 10 kandidatë për magistratë nga kontingjenti i këshilltarëve ligjorë.

Për sa u përket kandidatëve që vijnë nga radhët e studentëve që kanë edhe tre vjet eksperiencë, Shkolla nuk e organizon dot provimin. Prandaj një propozim i tillë është plotësisht i arsyeshëm dhe ne mendojmë se mund të ketë mirëkuptimin tuaj për të kaluar, me qëllim që Shkolla të funksionojë siç duhet, për më tepër procesi i reformës në drejtësi, i cili ka nisur të ecë me vizionin që ka pasur në fillim dhe që të konkretizohet me kandidatët e rinj që vijnë nga Shkolla e Magjistraturës, të cilët plotësojnë vendet bosh që janë krijuar në sistem, ende pa filluar procesi i rivlerësimit kalimtar.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Zoti Sadushi, jeni dakord me numrin që propozojmë ne në nenin 2 të projektligjit? Ne kemi propozuar 25 kandidatë, a jeni dakord me këtë numër, apo mendoni se ky numër mund të jetë më i madh?

Sokol Sadushi – Atëherë, duke pasur parasysh kapacitetet që ka Shkolla, ne që kur u miratuar projektbuxheti i këtij viti kemi qenë të përgatitur që Shkolla mund të mbajë maksimumi për vitin 2018-2019 jo më shumë se 50. Pse kemi parasysh këtë shifër dhe pse në

variantin që ju keni propozuar është 25?! Kjo për arsye se është pasur në vëmendje se si do të dilte testimi i këshilltarëve ligjorë që u zhvillua në maj. Në qoftë se nga ky testim, ku ishin rreth 47 kandidatë, do të kishin fituar të gjithë, Shkolla nuk do të kishte nevojë për një ndryshim të tillë, sepse 47 kandidatë plotësoheshin brenda numrit 50, që maksimalisht Shkolla e mbulon nga pikëpamja infrastrukturore dhe financiare. Fakti që ne sot jemi para një momenti që në Shkollë nuk mund të hyjnë më tepër se 10 kandidatë nga këshilltarët ligjorë, sigurisht që është i justifikueshëm dyfishimi i këtij numri, nga 25 në 50 për këtë vit akademik. Kështu që nuk krijon ndonjë problematikë për Shkollën ky propozim.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Sadushi!

Nga misioni EURALIUS, zonja Bernhard.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Pra, ju falënderoj të gjithëve për këtë iniciativë dhe për ato që parashtruat!

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për nevojën e këtyre ndryshimeve. Në vijim të asaj që tha edhe drejtori i Shkollës së Magjistraturës, jam shumë dakord që ky numër të mos kufizohet te numri 25, por ta rritim, sipas kapaciteteve që kemi, deri në 50 me kandidatët e rinj që do të futen në vitin akademik dhe kjo reformë është mirë të jetë e suksesshme dhe kjo që po themi tani është elementi thelbësor i këtij sukcesi.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Nga OPDAT-i?

Urdhëroni, zoti Smibert!

Jonn Smibert – *(përkthen përkthyesja)* Zoti Manja, ju falënderoj të gjithëve për iniciativën që keni ndërmarrë për të rishikuar ndryshimet në këtë ligj! Shtetet e Bashkuara e mbështesin vazhdimisht operimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës dhe është një shembull shumë i mirë i asaj çfarë mund të bëhet në Shqipëri. Besoj se numri i atyre që janë kundër Shkollës së Magjistraturës dhe kapacitetit për të hapur më shumë vende është shumë i vogël. Ne jemi dakord me formulimin e përgjithshëm të ndryshimeve dhe propozimeve, si dhe jemi të hapur të dëgjojmë më tej diskutimet. Gjithashtu, jam dakord me zotin Sadushi, që nuk është mirë të limitohet në minimum numri në këtë kohë dhe është më mirë të kemi një numër më të lartë pranimesh.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Smibert!

Urdhëroni, zoti zëvendësministër!

Toni Gogu – Zoti kryetar, ne e shikojmë si të domosdoshëm ndryshimin që ju sugjeroni, i cili rregullon të gjithë situatën që ka ardhur për shkak të vonesave që kemi pasur në procesin e rivlerësimit kalimtar. Ne mendojmë se duhet të standardizohet dhe të jetë rreth 50, pra çdo vit numri të jetë 50, meqenëse ky ishte edhe numri maksimal që Shkolla e Magjistraturës mund të përballonte.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Përpara se ta votojmë në parim, a ka diskutime nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Naço!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Në pamje të parë duket sikur projektligji është një rutinë e zakonshme, sikur janë të gjithë të gëzuar që ka ardhur ky projektligj, me këto ndryshime. E vërteta nuk është kështu, pasi nuk i është bërë një analizë pse erdhëm në këtë moment. A ka pasur një analizë të sistemit të drejtësisë, si nga Ministria e Drejtësisë, por edhe nga Komisioni i posaçëm i Reformës në Drejtësi për arsytet pse iu hoq kjo kompetencë Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo Prokurorit të Përgjithshëm? Pra, unë nuk mund ta pranoj që këtij Këshilli të Lartë të Drejtësisë t'i dërgojmë përsëri që të bëjë emërimet e këtyre magjistratëve, pasi të gjithë ne këtu qoftë opinionistë, politikanë, qoftë edhe nga përfaqësuesit e trupit diplomatik e kemi anatenuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë për moseficiencën e tij në gjithë këto vite. Jo pa qëllim reforma në drejtësi Këshillit të Lartë të Prokurorisë i hoqi Presidentin e Republikës, i hoqi Prokurorin e Përgjithshëm, kryetarin e Gjykatës së Lartë për arsye se ky Këshill nuk e bënte siç duhet detyrën.

Me Këshillin e Lartë të Drejtësisë kam pasur një eksperiencë të hidhur, pasi prej 2 vjetësh kam kërkuar që të emëroheshin të gjithë magjistratët, sepse Shkollën e Magjistraturës e kam vlerësuar si më të mirën në Shqipëri, që ka hedhur bazën dhe themelin e reformës në drejtësi. Sot nga 370 gjyqtarë, 180 janë magjistratë që operojnë në sistemin e drejtësisë, kanë kaluar më shumë se gjysmën e këtij sistemi, dhe prej vitesh Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk i emëron. Nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë kam kërkuar që 13 magjistratët, të cilit kishin 2 vjet që kishin mbaruar, të emëroheshin në gjykatën e Tiranës. Çfarë ndodhi? Këshilli i Lartë i Drejtësisë më të mirin e ka dërguar në Tropojë, apo në rrethin më të largët, në Përmet. Pra, nuk mund të pranoj, për hir të një kompromisi në emër të reformës, që ne ta lejojmë të njëjtin Këshill që të emërojë këta gjyqtarë magjistratë. Pra, t'i mësojmë këta gjyqtarë që t'u luten dhe të kapin një nga një të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për t'i emëruar në

një vend të përshtatshëm, sipas formimit të tyre akademik. Pra, kjo është një nga arsyet kryesore që ky Këshill nuk e ka më moralin që të vazhdojë, të kthehemi pas, në emër të reformës në drejtësi për 1 javë, për 2 javë apo për 1 muaj t'ia lëmë përsëri këtij Këshilli.

Jo më shumë se 1 muaj më parë ka qenë ministrja e Drejtësisë, ku ka takuar të gjithë Këshillin e Lartë të Drejtësisë, sepse nuk merrte masat e duhura, procedimet e duhura që kishte dërguar ministrja e Drejtësisë. Si ish- ministër i Drejtësisë për 2 vjet bashkë me Inspektoratin e Lartë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, kam proceduar rreth 47 gjyqtarë, nga këta 24 i kam dërguar për shkarkim nga detyra, dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shkarkuar me gishtat e dorës. Pra, në emër të kësaj reforme, nuk mund të pranojmë që të kthemi 180 gradë pas, të kthemi tek këta anëtarë të Këshilli të Lartë të Drejtësisë, apo edhe te Prokurori i Përgjithshëm i përkohshëm, që e sollët për 2 muaj, por që po vazhdon me muaj, që të bëjë emërimin vetëm Prokurori i Përgjithshëm, sepse nuk mund të flasim për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ka qenë inekzistent. Prandaj, në emër të reformës, kemi kërkuar që të kishte, një Këshill, siç është Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dhe jo një organ konsultativ që të bënte emërimet. Nëse do të vazhdojmë dhe të kthehemi pas, në emër të reformës, pa i bërë një analizë qëndrimit dhe arsyes pse erdhëm deri këtu dhe të kthehemi përsëri pas, unë besoj se është gjëja më e gabuar që bëjmë.

Sigurisht, mendoj që të ketë një zgjidhje për studentët, të ketë një zgjidhje për magistratët, të cilët për të hapur dhe zgjeruar Shkollën e Magistraturës, por do të isha shumë i rezervuar që t'i besoj emërimin e këtyre magistratëve Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pa përjashtim të gjithë anëtarëve të këtij Këshilli, duke hequr 3 apo 4 anëtarë që gjatë gjithë kohës kemi bashkëpunuar në mënyrë të shkëlqyer, kurse pjesa tjetër do të kërkojë qokën e radhës. Në qoftë se e lëmë projektligjin siç është, atëherë Prokurori i Përgjithshëm i përkohshëm do të bëjë qokën e radhës, pra të emërojë 13 studentët magistratë, ku e shikon Prokurorja e Përgjithshme, pa u konsultuar me askënd, sepse nuk besoj se konsultohet me Këshillin. Pra, një Prokurorë e Përgjithshme e përkohshëm të ketë mundësi me ligj që të emërojë 16 apo 13 studentë, sepse nuk e di numrin saktë.

Në emër të Lëvizjes Socialiste për Integrim, sot do të abstenoj në lidhje me këtë projektligj, pasi më duhet ta diskutoj edhe më Grupin Parlamentar të LSI-së mënyrën e votimit të këtij projektligji, sepse është shumë i rëndësishëm, por mënyra se si ka ardhur, me një relacion me tri rreshta, me dy nene, dhe e padiskutuar, është vetëm që propozuesi të bëjë qokën e radhës, ai që do t'i votojë të bëjë qokën e radhës dhe qokën e radhës ai që do t'i marrë në provim. Duke bërë të gjithë qokën e radhës, nuk arrijmë asgjëkundi për qëllimin për

të cilin jemi nisur të gjithë bashkë pa marrë meritat asnjëri apo tjetri për të bërë reformën në drejtësi. Pra, sot shikoj që ju heshtni, por kur doni të merrni meritat, ju i merrni të gjitha meritat dhe thoni se keni bërë reformë në drejtësi. Sot jemi në një moment ku duhet të analizohet arsyeja pse erdhën në këtë ditë dhe pse duhet t'i japim shansin edhe një herë Këshillit të Lartë të Drejtësisë që të bëjë qokën e radhës. Besoj se do të jeni ju ata që do të vendosni, pasi thashë në emër Grupit Parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim sot do të abstenoj, duke marrë një qëndrim të unifikuar me të gjithë grupin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Bushka!

Më pas fjalën e ka relatori.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam vetëm një sqarim teknik. Në fakt, gjykoj, dhe më duhet ta them, se ky është një nga ato projektakte që duhet ta diskutojmë dhe ta bëjmë së bashku. Pa diskutim fryma e bashkëpunimit dhe mundësia për dialog me të gjithë aktorët politikë për këtë ndryshim është momenti të reflektohet në të vërtetë dhe në praktikë, sepse ky është një ndryshim, që i shërben të gjithë zbatimit të drejtë të reformës në drejtësi. Mendoj se këtu ka mundësi të jashtëzakonshme që ne së bashku të ulemi dhe ta diskutojmë dhe të gjejmë zgjidhjet më të mira. Besoj se të gjithë kolegët janë dakord në lidhje me këtë pikë, që mirëpresim çdo sugjerim.

Nga na tjetër, më duhet të bëj një sqarim teknik, ne nuk kemi shpikur rrotën me këtë projektligj që ju kemi sjellë. Ajo që teknikisht po bëjmë është se dispozitat kalimtare në ligjin aktual, që ne kërkojmë të ndryshojmë, thjesht po i shtyjmë në kohë. Po t'u referohemi neneve 160 dhe 170 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” të cilët parashikojnë periudhën kalimtare se çfarë do të ndodhë me emërimin e kandidatëve që do të rekrutoheshin, që do të mbaronin në vitin 2016 Shkollën e Magjistraturës dhe duhet të emëroheshin në pozicionet e punës, gjithashtu për rekrutimet e vitit në vijim, çfarë bëjmë ne këtu? Ne thjesht po shtyjmë këtë periudhë që parashikojnë dispozitat kalimtare. Pra, vitin 2016 po e bëjmë 2018, nuk po kthehem pas. Teknikisht dua t’jua shpjegoj këtë gjë: ne thjesht po shtyjmë periudhën kalimtare për efekt të kalimit të një situatë bllokimi që është duke na ardhur nga mosngritja e dy organeve, KLGJ-së dhe KLP-së. Do të ishte shumë mirë që ne të kishim kohë të zbatonim ligjin, siç ishte miratuar, që sot të mos kishim nevojë të sillnim këtë projektakt, por na duhet ta adresojmë këtë shqetësim. Propozimi ynë është thjesht teknik, pra për ta qartësuar edhe për ju, edhe për publikun. Megjithatë, mendoj se këtu ka vend për të

diskutuar të gjithë së bashku dhe do të ishte shumë mirë që këtë nismë ta miratonim me votat dhe me vullnetin e të gjithë aktorëve politikë në Kuvend.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Do t'ju lutesha që, nisur edhe nga sqarimet e plota që drejtori dhe përfaqësuesi i Shkollës së Magjistraturës paraqitën para Komisionit të Ligjeve nga njëra anë, sikurse edhe nga qëndrimi i përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë dhe nga misionet mbështetëse EURALIUS-i dhe OPDAT-i, me mirëkuptimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, të dakordësonim që numri i kuotave në vijim për vitet pasardhëse të jetë 50 dhe të ishim në një gjuhë të përbashkët lidhur me numrin e kuotave vakante. Sikurse e paraqiti dhe drejtuesi i shkollës, Shkolla i ka të gjitha kapacitetet e duhura për ta përballuar një fluks të tillë.

Së dyti, në vijim të sqarimeve që kolegja Bushka bëri për nevojën e një iniciative të tillë ligjore, gjej rastin të ftoj të gjithë kolegët e opozitës, pa dallim, si të Partisë Demokratike, por edhe të LSI-së, duke qenë edhe bashkëhartuesit e të gjithë ligjeve organike apo specifikisht të ligjit organik, të cilin jemi duke prekur, që të marrin të gjithë kohën e nevojshme, sikurse ne jemi të hapur për të dakordësuar qëndrimin tonë lidhur me këtë iniciativë, me qëllim që ta kapërcejmë këtë fazë transitore dhe t'i japim të gjithë mbështetjen e nevojshme shkollës për realizmin e misionit të saj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – A ka diskutime të tjera?

Urdhëroni zonja Hysi !

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të falënderoj nismëtarët për këtë nismë që kanë ndërmarrë!

Në fakt, e ndoqa me vëmendje diskutimin që bëri kolegu Naço, të paktën ne si maxhorancë asnjëherë nuk e kemi mohuar rolin që ka luajtur Lëvizja Socialiste për Integrim në miratimin e ligjeve të reformës në drejtësi, sepse pa votat tuaja, ne nuk do të kishim mundur të kalonim me 84 vota paketën e ligjeve të reformës në drejtësi. Por ajo që dua të theksoj është se ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë” është në proces diskutimi, sepse ne duhet të reflektojmë vendimet e Gjykatës Kushtetuese në këtë ligj. Nëse do të ishin miratuar të gjitha ndryshimet, pra me votat tuaja, por edhe të kolegëve të opozitës, konkretisht të Partisë Demokratike, dhe do të kishim përshpejtuar procesin e ngritjes së këtyre institucioneve, ne nuk do të ishim në këtë diskutim që jemi sot,

për të bërë ndryshime të tilla dhe për të zgjatur mandatin e emërimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo nga Prokurori i Përgjithshëm, i caktuar përkohësisht. Në këtë kuadër, dua të theksoj, meqenëse ju do të keni mundësi të diskutoni edhe për mënyrën se si do ta votoni këtë projektligj, dhe kam besim se do t'i bashkoheni votës sonë për ta kaluar këtë ndryshim, të shikoni edhe mundësinë për ndryshime të tjera, të cilat po rrinë pezull në Këshillin e Legjislacionit lidhur me reflektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Fjalën e ka zoti Hyseni. Pastaj fjalën e ka zoti Braho.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Ky është një ligj i rëndësishëm dhe unë nuk dua të ndalem shumë, pasi disa nga kolegët renditën në mënyrë shteruese argumentet pse është e domosdoshme që të ndërhyhet në këtë ligj, por nuk mund të rri pa përmendur faktin që disa nga argumentet e zotit Naço duhet të gjejnë mbështetje nga ne. Unë i bashkohem shqetësimit të tij që dy organe, të cilave ne do t'u japim kompetenca për emërim dhe caktim të kandidatëve, mund ta kenë humbur pjesërisht legjitimitetin nga praktika e deritanishme, disa e kanë humbur juridikisht dhe, ky ka qenë një nga argumentet kryesore që ne kemi nisur reformën në drejtësi, këtu e kam fjalën për KLD-në, ndërkohë që ka kontestime politike për organin tjetër, që është Prokurori i Përgjithshëm i përkohshëm. Në këto kushte, unë sugjeroj që ne të gjejmë një mekanizëm zhblllokues ose kontrollues, duke e futur elementin e shortit në të gjitha parashikimet, që do të thotë të mos i lihet në dorë një vullneti të cunguar të këtyre organeve, sidomos KLD-së, dhe të parashikojmë që në çdo rast të fusim termin “me short”, për shembull “emëron me short magistratët”, “merr vendim për caktimin me short në pozicionet e kandidatëve magistratë”. Unë mendoj se futja e termit “short” mund të gjejë edhe mirëkuptimin e Shkollës, pasi bëhet për të shmangur ndonjë keqkuptim të mundshëm, por e rëndësishme është që ne të realizojmë synimin, daljen nga ngërçi që është krijuar për shkak të moskrijimit të këtyre institucioneve. Nuk duhet të kemi turp, pasi ligje perfekte dhe ligje që parashikojnë çdo situatë nuk ka, prandaj është bërë një reformë e madhe dhe e detajuar, e cila prodhoi një situatë të pamundur për t'u parashikuar, prandaj është edhe parlamenti. Në këto kushte, unë mendoj se do të gjendet dakordësia midis forcave politike, të paktën midis PS-së dhe LSI-së për të miratuar këto ndryshime.

Ashtu siç tha edhe kolegja Hysi, unë jam i interesuar të ftoj më opozitën në tërësi dhe LSI-në në veçanti për të kaluar paketën, që është e domosdoshme për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, e cila prej disa kohësh, edhe për shkak të mosimpenjimit të opozitës në

aktivitetet parlamentare, ka ngelur në *stand by* në Këshillin për Legjislacionin, por në thelb është mungesa e vullnetit për të kaluar këto ndryshime. Këto ndryshime nuk janë politike, por janë të domosdoshme për këtë reformë, në prag edhe të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Unë ju ftoj që të reflektojme për mbledhjen tjetër dhe të garantojmë kuorumin e duhur për këtë ligj, duke bërë edhe korrigjimet e mundshme nëse relatori, propozuesi, Shkolla dhe aktorët e tjerë bien dakord me propozimet e mia për termin “short”.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Hyseni!

Zoti Braho, fjala për ju.

Spartak Braho – Nuk dua të zgjatem shumë, sepse kolegët parafolës vlerësuan rëndësinë e propozimeve dhe dobishmërinë e tyre, por ajo që dua të theksoj dhe të ripërsëris është fakti se ne në seancën e kaluar miratuam Komisionin e Monitorimit të Zbatimit të Ligjeve për Reformën në Drejtësi, ndërkohë që në ligj është parashikuar ndjekja e zbatimit të reformës. Për shumë arsye ne jemi të vonuar në zbatimin e ligjeve, nuk është momenti që të flas këtu, por dua të them që ne kemi ndjekur një metodikë jo shumë të saktë për zbatimin e tyre. Korrigjimet që duhen bërë në legjislacion janë urgjente.

Ligji që propozohet është një inicim i mirë, por Komisioni i Ligjeve së bashku me Komisionin e Monitorimit dhe me strukturat ndërkombëtare duhet të na propozojnë urgjent që të kalojmë ndryshime dhe përmirësime të tjera. A është e mundur që ne ta bëjmë këtë javën që vjen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju që i morët dekoratat, t’i mbanit, mos i flaknit.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Braho!

A ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Unë dua të shtoj dy gjëra.

Parimisht nuk do të doja për asnjë sekondë që KLD-ja aktuale dhe Prokurori i Përgjithshëm i përkohshëm të bënin emërimin e magjistratëve dhe as të përcaktonin kuotat për Shkollën e Magjistraturës. Besoj se për këtë biem dakord të gjithë, por jemi para kësaj situatë për shkak të rrethanave të krijuara, për shkak të mosngritjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si rezultat i procesit të vetingut, madje edhe ligji “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë” nuk është bërë akoma eficient.

Në datën 1 korrik, sipas rakordimit që kemi bërë me Shkollën e Magjistraturës, në qoftë se nuk gaboj, kandidatët për magistratë mbyllin ciklin e plotë të studimeve, diplomohen dhe presin emërimin, por në kushtet aktuale, për shkak të ezaurimit të parashikimeve ligjore të bëra në nenet 160 dhe 170 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, emërimi tyre nuk mund të bëhet.

Së dyti, për shkak të moskrijimit të KLGJ-së dhe KLP-së, Shkolla e Magjistraturës nuk mund të hapet në shtator ose tetor.

Me ecurinë e procesit të vetingut, sot ne nuk jemi në gjendje të themi se kur do të mbyllet cikli i vetingut për të gjitha kandidaturat për prokurorë dhe gjyqtarë, të cilët janë në garë për në KLGJ dhe në KLP. Në muajin korrik diplomohen studentët e Magjistraturës dhe në muajin shtator ose tetor hapet Shkolla e Magjistraturës, por kandidatët që do të shkojnë në këtë shkollë do t’i nënshtrohen procesit të konkursit dhe, për të zhvilluar konkursin në muajt shtator ose tetor, duhet një periudhë përgatitore korrik–gusht, domethënë kjo është një periudhë përgatitore jashtëzakonisht e shkurtër. Kjo ishte një nga arsyet që ne e pamë të shkëputur nismën tonë nga pjesa e ndryshimeve, që janë në Këshillin e të Legjislacionit, lidhur me ligjin e statusit dhe ligjin e organeve të qeverisjes, për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sepse gjatë gjithë procesit të hartimit të reformës në drejtësi, të gjitha forcat politike kanë rënë dakord për Shkollën e Magjistraturës. Kjo ka qenë e vetmja pikë, ku maxhoranca dhe opozita kanë qenë *unison*, kjo edhe për shkak të kredibilitetit që kjo Shkollë ka krijuar ndër vite.

Ne e kemi diskutuar edhe sugjerimin që bëri kolegu Hyseni. Në fakt, para se të ndërmerim nismën, e kemi diskutuar edhe këtë, por Shkolla e ka kundërshtuar këtë variant, sepse studentët, për shkak të studimeve që bëjnë në atë Shkollë, kanë një vlerësim merite dhe nuk mund t’i nënshtrohen shortit. Vlerësimi, sipas renditjes që bëhet me pikë dhe për shkak të provimeve që japin në Shkollën e Magjistraturës, fillon nga i miri dhe me radhë.

Në fakt, emërimi i magistratëve bëhet sipas meritës së gjithsecilit prej kandidatëve, ndoshta në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nuk ka funksionuar kështu dhe nuk kam arsye ta kundërshtoj, sepse këtu është i pranishëm ish-ministri i Drejtësisë, i cili ka asistuar në mbledhjet e Këshillit aktual të Lartë të Drejtësisë, por le të biem dakord që do të ndiqet një parim i meritës së kandidatëve magistratë në emërimin që do të bëjë Këshilli aktual i Lartë i Drejtësisë. Ne ndodhemi para kësaj situatë dhe kjo ishte një nga arsyet që ne propozuam nismën, natyrisht duke u dakordësuar me Shkollën dhe me misionet e nderuara që kemi në komision. Pra, i kemi ezauruar të gjitha rrugët e mundshme sesi mund të dalim nga kjo situatë

dhe e vetmja zgjidhje është ndërhyrja te ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, konkretisht në nenet 160 dhe 170. A duhet patjetër vota e opozitës?! Sigurisht që duhet, sepse është një ligj organik dhe për të kaluar këto dy ndryshime kërkohen 84 vota. Në fakt, vota e opozitës nuk duhet vetëm për këto dy ndryshime, por për të gjithë paketën e ndryshimeve që do të duhet të bëhen në ligjin e statusit të gjyqtarëve dhe në ligjin për organet e qeverisjes së sitemit të drejtësisë.

Unë bashkohem me mendimin e kolegëve dhe gjej rastin t’i ftoj kolegët e opozitës që edhe këtë herë të jemi të gjithë bashkë për Shkollën e Magjistraturës, sepse kemi rënë dakord që ta fusim në trungun e Kushtetutës. Ne kemi rënë dakord dhe kemi thënë se gjyqtar dhe prokuror në Republikën e Shqipërisë nuk mund të bëhesh më pa mbaruar ciklin e plotë të studimeve në Shkollën e Magjistraturës. Duhet vullnet politik që t’u japim mundësinë kandidatëve të rinj t’i nënshtrohen programit të konkursit dhe më pas trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Kështu që, zoti Naço, shfrytëzoi rastin t’ju bëj thirrje, edhe si përfaqësues i forcës politike që ju përfaqësoni, që për këtë ligj, të cilin e kemi kaluar së bashku në Komisionin e Reformës në Drejtësi, të jemi përsëri bashkë. Kjo thirrje vlen edhe për deputetët e Partisë Demokratike, sepse ata kanë qenë iniciatorët që Shkollën e Magjistraturës ta fusin në trungun e Kushtetutës, si një nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Unë ndjehem mirë që bëmë këtë zgjidhje në atë kohë, sepse ky është një institucion, i cili që në ditën e parë dhe deri sot është asistuar nga misionet e Bashkimit Europian, por edhe nga miq dhe partnerë të tjerë. Kjo Shkollë ka kredibilitetin e duhur si laborator nga ku do të dalin gjyqtarët dhe prokurorët e ardhshëm në këtë vend. Kështu që unë ju ftoj ta votoni në parim dhe nen për nen këtë nismë.

Zoti Naço, fjala për ju.

Nasip Naço- Nëse ju e keni seriozisht që doni ta kaloni këtë projektligj dhe doni edhe votat e opozitës, apo votën time personale, ndani nenin 160 me nenin 170, gjërat mund t’i diskutojmë dhe vota ime mund të jetë edhe në kundërshtim me vendimin që mund të marrë Grupi Parlamentar i LSI-së, por për arsyet që thashë më lart, që këta 16 magjistratë t’ia çojmë të njëjtit Këshill të Lartë të Drejtësisë që të bëjë qokën e radhës, unë nuk kam për ta votuar asnjëherë nenin 160. Unë jam plotësisht dakord që t’i hapet rruga Shkollës së Magjistraturës, që këta 30 apo 50 studentë të vazhdojnë studimet në këtë shkollë, por të mos ngatërrojmë imazhin e Shkollës me imazhin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në qoftë se këto dy institucione do t’i bëni bashkë, unë personalisht nuk kam për ta votuar nenin 160, paragrafi 1. Në qoftë se neni 170, paragrafi 3, do të jetë më vete, sigurisht që asnjë nga ne nuk është

kundër që Shkolla e Magjistraturës të vazhdojë dhe të ketë 30 ose 50 kandidatë, sepse kjo është baza e reformës në drejtësi. Jo pa qëllim e thashë pak më parë se nga 370 gjyqtarë, mbi 180 janë gjyqtarë magjistratë, kaq janë edhe prokurorë, ndaj le të vazhdojmë me këtë traditë të mirë që ka sistemi ynë gjyqësor, i cili vlerën më të mirë ka Shkollën e Magjistraturës, por, nëse ju doni ta ngatërroni KLD-në me Shkollën e Magjistraturës, bëni gabim dhe personalisht me mua nuk keni për ta gjetur kompromisin. Pra, në çdo rast do të votoj kundër nenit 160 dhe pro nenit 170.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Naço, por shqetësimi mbetet i njëjti, a do të emërohen magjistratët që do të diplomohen në datën 1 korrik, apo jo? Sepse shqetësimi ynë është nëse këta 13 apo 16 studentë do të emërohen.

Ulsi Manja – Po, zoti Naço.

Nasip Naço – Nga eksperiencia ime në KLD, 13 studentët magjistratë do të shkojnë të kërkojnë votën e 15 anëtarëve të KLD-së, do t'i mësoni që ditën e parë me ryshfetin, do t'i mësoni që ditën e parë të jenë borxh, qoftë edhe politikisht ndaj Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që do t'u kërkojnë borxhin për vite me radhë, që të emërova në Tiranë dhe nuk të emërova në Tropojë; të emërova në Durrës dhe nuk të emërova në Sarandë apo të emërova në Elbasan dhe nuk të emërova në Përmet. Pra, mos e bëni këtë gabim, sepse nga ky moment këta 13 gjyqtarë dhe 13 prokurorë i mësoni që të kërkojnë nderin e radhës dhe ta kthejnë këtë nder pasnesër. Kjo është kazma që po i vini reformës, nëse do të bashkoni Shkollën e Magjistraturës, e cila ka vlera të pallogaritshme, me KLD-në. Të gjithëve po të na pyesësh, e dimë se çfarë perceptimi kemi për KLD-në.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

Zonja Bernhard e ka fjalën!

Agnes Bernhard - *(përkthen përkthyesja)* Faleminderit!

Kërkoj t'ju tërheq vëmendjen se ligji për statusin përqendrohet në 2 pika.

Dua të cilësoj se në momentin që gjykatësi emërohet, nuk i jepet një vend pune, por ai thjesht pranohet të jetë pjesë e radhëve të gjyqtarëve, të prokurorëve. Pra, ai do të ketë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, por nuk i jepet një vend pune.

Më tej, në nenin 160 është momenti tjetër, ku bëhet dallimi tjetër, ku merret një vendim tjetër me të cilin i caktohet një vend pune konkret këtij magjistrati. Ndoshta ju mund të bëni një përcaktim të mëtejshëm dhe të lini vetëm germën “a”.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Faleminderit edhe për sugjerimin!

Në fakt këto janë detaje, që i përkasin diskutimit nen për nen që do të bëjmë për projektligjin.

Ta hedhim në votim në parim, në fillim!

Kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””?

Kush është pro në parim?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë””.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen të këtij projektligji!

Meqë pati sugjerime për nenin 1, që ndryshon nenin 160 të ligjit nga misioni EURALIUS, që të marrim në konsideratë vetëm ndryshimin e germës “a” dhe jo atë të germës “b”, duke i shkuar argumentit që emërohet në një pozicion dhe nuk merret vendim për emërimin.

Çfarë thotë neni 160, në pikat “a” dhe “b”?

Ky nen thotë: “Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të parashikuara në këtë ligj:

a) emëron magjistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II, i këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) merr vendim për caktimin në pozicion të kandidatëve magjistratë të diplomuar në vitin 2016, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;”

Ky është neni 160 i ligjit aktual. Ndryshimi që propozojmë kolegja Bushka dhe unë konsiston. Mund ta lexoni për efekt regjistrimi!

Klotilda Bushka – Propozohet që të bëhet ky ndryshim në nenin 160 të ligjit, me nenin 1 të projektligjit: “ Në nenin 160 bëhen ndryshimet si vijon: 1. Në pikën 1, shkronjat "a" dhe "b" ndryshohen: "a) emëron magjistratët kandidatë të diplomuar nga Shkolla e

Magjistraturës, në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, brenda një muaji nga diplomimi;

b) merr vendim për caktimin në pozicion të kandidatëve magjistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda dy muajve nga diplomimi;

2. Në pikën 2, shkronjat "a" dhe "b" ndryshohen:

"a) emëron magjistratët kandidatë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, brenda një muaji nga diplomimi;

b) merr vendim për caktimin në pozicion të kandidatëve magjistratë të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda dy muajve nga diplomimi."

Ky është sugjerimi, që propozojmë ne.

Ulsi Manja – Ka komente për propozimin tonë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Urdhëroni!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Hyseni bëri një propozim në lidhje me futjen e shortit te pjesa e emërimit.

Një nga meraket kryesore që kishte edhe zoti Naço, ishte që magjistratët të mos fillojnë që ditën e parë, apo para kësaj dite, me qoka, me lutje etj.

Deri diku, futja e shortit e mënjanon këtë gjë. Problemi që mbetet me shortin është ajo që sapo tha edhe drejtori i shkollës, që lidhet me meritën. Si do të garantojmë ne që emërimet të jenë sipas meritës?

Unë mendoj se duke qenë një dispozitë tranzitore, mund ta kapërcejmë. Pra, po të vëmë në balancë atë që humbim në rast se e vendosim me short me atë që fitojmë dhe këtu gjëja kryesore që fitojmë është një konsensus i gjerë edhe nga kolegët e opozitës. Unë mendoj se nëse e vëmë shortin, arrijmë një konsensus, që kënaq edhe qëllimin e propozuesve, pra që ta zhbllokojmë situatën, por edhe nuk humbasim ndonjë gjë të madhe, sepse e dimë që e gjithë trupa e magjistratëve është përgjithësisht ekselente dhe me studentë shumë të mirë. Kështu, nuk ka ndonjë diferencë të madhe midis magjistratëve, në lidhje me meritën. Kështu, më duket racional propozimi i zotit Hyseni, nëse nuk ka gjë tjetër ligjore, që lidhet me futjen e shortit si instrument për ta zhbllokuar këtë situatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Për të ta shpjeguar, po marr një situatë hipotetike. Nëse janë 10 vende për 10 emra, atëherë hidhet shorti për secilin emër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Ai që ka mbaruar shkëlqyeshëm mund të vejë në një prokurori edhe më të rëndësishme, që të japë edhe më shumë, sepse me short mund t'i bjerë të vejë edhe njërit, që nuk i ka mbaruar studimet si ai.

Bledar Çuçi – Ky është argumenti që bëra unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Me radhë!

Bledar Çuçi – Për ta vënë edhe një herë në tryezë propozimin që bëri zoti Hyseni. Kjo ishte ideja

Ulsi Manja – Fjalën e ka drejtori i shkollës!

Sokol Sadushi – Nëse më lejoni, unë do të doja të bëja një sqarim, lidhur me këtë situatë. Për sa i përket shortit, vërtet mund të bëhet nga ligjvënësit, por duhet të keni parasysh se ligji për qeverisjen dhe ligji për statusin përcaktojnë rregullat se si bëhet emërimi i kandidatëve dhe këto rregulla nuk e pranojnë shortin, por pranonin emërimin sipas renditjes, sepse pranojnë cilësinë.

Para dy vjetësh, në mos gaboj, është bërë kjo gjë nga KLD-ja, që duke mos e respektuar ligjin, vendosi shortin dhe ka krijuar një problematikë, sepse nuk merr për bazë meritën. Të gjithë studentët kur hyjnë në shkollë, luftojnë pikërisht renditjen. Vendosja e shortit e zhbën tërësisht meritën. Të paktën ligji me 3/5 nuk e lejon, sepse kur emërohet kandidati për magjistrat do të caktohet mbi bazën e renditjes përfundimtare, që ata kanë pasur gjatë 3 vjetëve të shkollës. Ky nuk opinionimi im, por rrjedh nga ligji. Ligji vetë nuk e lejon shortin.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Çuçi!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Jam shumë dakord. Si rregull i përgjithshëm ky është. Ne po flasim për një dispozitë kalimtare për të zhbllokuar një situatë shumë specifike, që është krijuar. Po u kthehem organeve ekzistuese dhe jo organeve të reja që kemi krijuar, për t'i futur në lojë, në mënyrë që të zhbllokojmë situatën. Duke qenë një situatë tranzitore, e cila nuk shkon sipas logjikës të

së gjithë strukturës që kemi ngritur me sistemin e ri, me reformimin që i kemi bërë sistemit të drejtësisë, unë them që në këtë moment, për një periudhë të shkurtër sa ta zhblllokojmë këtë situatë, nuk mendoj se kjo e para bie në kundërshtim, sepse rregulli flet për 2 organe të tjera, të cilat ne do t'i anashkalojmë nëpërmjet dispozitës kalimtare, por them se kjo e zhbllokon situatën dhe tenton të arrijë një konsensus. Megjithatë, thashë se nuk marr përsipër të bëj një argument ligjor dhe shterues në lidhje me këtë, nëse është në kundërshtim me ligjin, apo jo.

Besoj se për sa i përket kundërshtisë me ligjin ky moment është kapërcyer, nëse ne kemi vullnet për ta propozuar sipas ligjit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çuçi!

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e kuptoj shumë mirë zotin Çuçi. Duke qenë gjithmonë në krye të komisioneve kërkon konsensus me opozitën dhe mundohet të gjejë edhe një kompromis. Në fakt në dispozitën kalimtare, te neni 160, kur flitet për emërimin që do të bëhet deri në krijimin e KLD-së dhe të KLP-së, magistratët kandidatë të diplomuar emërohen sipas kriterëve të reja të ligjit për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit në RSH. Në nenin 35 të ligjit të statusit, ku flitet për emërimin e kandidatëve magistratë, pavarësisht se emërimi bëhet nga KLGJ-ja apo nga KLD-ja e sotme, është ajo që me të drejtë e tha zoti Sadushi. Ka epërsi, ka një renditje, ka një rregullim. Madje meraku që ka zoti Naço, deri diku është e zgjidhur nga ligji, sepse çdo kandidat për magistrat që të emërohet nuk mund të kapë pas xhaketës një për një personat, pasi ai ka ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni sa ta mbaroj!

Unë ju kam ndjekur gjatë gjithë kohës dhe nuk kam folur.

Ai ka të drejtë të japë 3 renditje preferenciale të tij dhe më pas, është KLD-ja që vendos për emërimin e tij.

Nga ana tjetër, nuk do të bënte sens që një kandidat për magistrat, i diplomuar, i cili është në fund të listës për nga vlerësimi, të kërkojë të emërohet në Gjykatën e Tiranës apo në atë të Durrësit, që hyjnë në gjykatat e kategorisë së parë.

Pavarësisht se emërimi bëhet nga këto institucione që janë tranzitore dhe që për fatin tonë të keq, po shkojnë tej limiteve dhe afateve kushtetuese, kriteret që përcakton dispozita kalimtare e ligjit për statusin kërkon të respektohen kriteret e kreut të dytë të këtij ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk e ndryshon dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka kërkuar zoti Hyseni.

Alket Hyseni - Faleminderit, zoti kryetar!

Jemi të gjithë dakord që nuk diskutohet, se rregulli i përcaktuar sot dhe që shpreh Shkolla, është më e mira e mundshme. Jemi të gjithë dakord se, në kushtet ideale ne nuk do të diskutonim fare këtu për këtë gjë dhe, patjetër, që meritokracia dhe vlerësimi do të ishin ndër kriteret kryesore, siç e ka parashikuar edhe ligji konkret, por ne, të nderuar kolegë, nuk jemi në ato kushte. Ne jemi në kushtet e një ngërçi, kur nuk shkojmë dot fare atje, sepse të dyja organet që do t'i zbatonin këto procedura nuk janë krijuar.

Tani është fare e lehtë që ne të dëshirojmë të kemi maksimumin, por nuk mund ta kemi më maksimumin. Pse? Kemi një organ, që është KLD-ja, i cili ka treguar se jo vetëm nuk e njeh më meritokracinë, si parim, por nuk njeh disa parime shumë më të rëndësishme, dhe prandaj kemi arritur në këtë ditë sot, sepse, po ta kishim KLD-në, që do të ishte parimore, apo jo, zoti Naço, ndoshta nuk do ta kishim bërë fare reformën në drejtësi, por do ta kishte bërë vetë ai organ rregullimin.

Jemi mes dy rrugëve: këta studentë magjistratë i çojmë te ky organ, që nuk njeh asnjë parim, dhe mund të ndodhë fare mirë ajo që të fillojë dhe të dalë në tender, pra jemi mes një tenderi, apo do të jemi mes një shorti, që minimalisht nuk e shkel ligjin. Pse?

Së pari, magjistratët e kanë minimumin e kriterit për të qenë magjistratë. Pa diskutim, janë të gjithë të kualifikuar mjaftueshëm për të qenë gjyqtarë ose prokurorë në çdo pozicion të mundshëm që hapet.

Së dyti, kanë pranuar të emërohen kudo. Që kur futen në konkurrim dhe anëtarësohen, ato pranojnë të emërohen kudo, kanë kontratë, sepse paguhen gjatë kohës kur janë studentë.

Së treti, nuk jemi në një rregull të përhershëm, por të përkohshëm. Unë mendoj se kjo gjë do të vlejë vetëm për vitin e parë të emërimit të tyre. Nuk ka për të ndodhur më, sepse, me shpresën dhe me procedurat, në vjeshtë ne do të kemi organet e reja, KLGJ-në dhe KLP-në, pra jemi vetëm për një rast.

Tani, nëse ne kërkojmë t'i kapim të gjitha, unë gjykoj se nuk do të mundemi t'i kapim të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do të isha...

Ju lutem, zoti Fino, se nuk mund të themi...

Ne duam t'i zhbllokojmë, që të mos rrimë në ngërç!

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Më lejo tani!

Unë e di që ligji ka disa kritere, por duhet të dini se studentët e Magjistraturës, ja tek është drejtori, ndahen shumë pak, sepse janë pothuajse të gjithë të shkëlqyer.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga historiku që ka pasur Shkolla.

Në këto kushte, unë mendoj se për një emërim të caktuar, gjë që është i korrigjueshëm më vonë, janë të gjithë mekanizmat e promovimit, pra nuk ngelen historikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le ta gjejmë këtë zgjidhje kompromisi.

Megjithatë, doni të synojmë maksimalen? Le ta synojmë, por unë gjykoj se nuk do të arrihet maksimalja.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Sadushi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është prezent?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – I gjithë problemi është te diskutimi që bëri kolegu im dhe që zoti Naço e ka problem, çështja e KLGJ-së dhe KLP-së, apo jo, sipas vetingut, që të kuptohemi edhe me publikun. Pra, ne nuk i kemi të gatshme këto dy organe sipas reformës në drejtësi, që të vazhdojë nga puna Shkolla e Magjistraturës.

Por për këtë që diskutoi kolegu im Hyseni, kur thotë se deri në vjeshtë këto organe do të jenë gati, prandaj dua edhe, si të thuash, të pyes veten këtu në këtë komision: a do të jenë vërtet gati deri në vjeshtë KLGJ-ja dhe KLP-ja? Në qoftë se janë gati, nuk kushton...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prit, mor, ta mbaroj arsyetimin tim, se nga ti mora shkas, vetë nuk do të flisja!

Tani, këtej thua se është gati, nga ana tjetër thua se nuk fillojnë.

Në qoftë se është gati, nuk u kushton asgjë studentëve të shkëlqyer që të rrinë dy muaj pa punë, sepse organi i ri i emëron pastaj dhe nuk ka nevojë as me short, as me zvarritje, as me kapërcime, por do të jenë organet e reja që t’i emërojnë dhe e zgjidhim, jemi në rregull.

Lidhur me pjesën tjetër të nenit 170, jam plotësisht dakord që ato t’i miratojmë, t’i kalojmë, që të hapet mundësia që Shkolla të nxjerrë magjistratë të rinj. Por në qoftë se këto dy organe ne i kemi gati, po, sepse nga pikëpamja, le të themi, e reformës, të cilën ne e bëmë dhe e kërkojmë, duket sikur po i shtrijmë dorën një institucioni, që realisht ne e kemi degjeneruar me të drejtë, pavarësisht se atje ka personalitete, duke filluar nga Presidenti i Republikës, nga ministria e Drejtësisë dhe shumë anëtarë të tjerë. Ndoshta nuk e kam fjalën për këta të dy, sa e kam për anëtarët e tjerë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam fjalën për anëtarët e tjerë.

Tani u themi atyre që, shikoni, nuk e bëmë dot KLGJ-në dhe KLP-në, e kupton, pra do të vijmë përsëri te ju të na thoni të emërojmë këta studentë që kanë.

Në qoftë se vërtet KLGJ-ja dhe KLP-ja do të bëhen gati në vjeshtë dhe kjo reformë është e gatshme që të bëhet sa më shpejt, unë them që këta studentë le të presin edhe dy muaj, por le të jetë institucioni i ri që t’i emërojë. Madje nuk duam t’ia shikojmë bojën fare kësaj KLGJ-je që është dhe t’i shtrijmë dorën.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka zoti Sadushi.

Sokol Sadushi – Më falni që e kërkova përsëri fjalën, por dua të bëj vetëm një sqarim, qoftë për ta bërë edhe pak më të thjeshtë situatën!

Në fakt, bëhet fjalë për dhjetë gjyqtarë dhe gjashtë prokurorë. E thashë këtë më tepër për të kuptuar edhe mbi bazën e shifrës, edhe për të konkluduar mbi atë që ju do të vendosni me ligj. Këshillit të Lartë të Drejtësisë, meqenëse do t’u referohet detyrimisht procedurave që ka ligji i ri, sipas ligjit të ri, i është kufizuar diskrecioni për të bërë ato gjëra që janë bërë përpara se të miratoheshin këto ligje.

Nuk dua të bëhem teknikien, por, në fakt, po të shikohet me shumë vëmendje ligji, do të kuptojmë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shumë diskrecion të kufizuar për nga mënyra se si ligji ka parashikuar emërimin e kandidatëve të rinj për magjistratë. Konkretisht, unë mund të them vetëm kaq: duke qenë se janë dhjetë kandidatë për magjistratë të profilit “gjyqtar”

dhe gjashtë të profilit “prokuror”, Këshilli i Lartë i Drejtësisë do të ketë në dorë për të emëruar vetëm gjashtë gjyqtarë të tillë.

Në dijeninë time, dhe ma mirëkuptoni këtë që them, ka vende bosh në të gjitha gjykatat e Republikës për sa i përket emërimit të dhjetë gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Duke qenë se renditja është vendimtare për ta, flas renditja që ata kanë marrë në Shkollën e Magjistraturës, ligji e ka dhe kjo nuk mund të anashkalohet. Ky është element i rëndësishëm, sepse duke i paraqitur dy pozicione që ka vende bosh në gjyqësor, për prokurorët dhe për gjyqtarët, do të zgjedhë pikërisht një ndër këto dy pozicione. Tendenca e tij është për të zgjedhur ato pozicione që atij i shkojnë më për shtat. Atëherë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka se çfarë të bëjë tjetër, përveçse të zgjedhë, të emërojë kandidat për magistrat pikërisht në një nga dy vendet që ai ka zgjedhur vetë. Prandaj, do të doja të ma mirëkuptoni këtë që them, pasi pushteti i tepruar që kishte më parë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për shkak të mënyrës si ishte miratuar ligji që, me të vërtetë është ajo që thotë zoti Naço, se nuk i merrte për bazë shumë nga këto kritere që përmendëm, tashmë, në gjykimin tim, është tepër i kufizuar.

U detyrova ta bëj këtë sqarim, sepse...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vendet vakante i shpall Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Prokurori i Përgjithshëm!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Fjalën e ka zoti Shameti, përsëri për procedurë.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, pak qetësi, e ka kërkuar fjalën për procedurë zoti Shameti, që është edhe relatori.

Adnor Shameti – Për të qenë operative, por edhe në vijim të të gjitha diskutimeve konstruktive, që të gjithë kolegët e nderuar, përfaqësuesi i Shkollës së Magjistraturës dhe misionet mbështetëse ngritën këtu, do të kërkoja mirëkuptimin e kolegëve që miratimin e propozimit për këtë projektligj ta shtyjme për një seancë tjetër, duke ripërsëritur thirrjen...

Në parim, po, por po flasim për shqyrtimin nën për nën dhe miratimin në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk diskutohet ndërhyrja në parim.

Siç po thosha, e ripërsëris thirrjen për kolegët e opozitës (si përfaqësuesve të Partisë Demokratike, ashtu edhe atyre të LSI-së), me qëllim që të ulemi dhe të kemi dakordësinë e të dyja grupeve parlamentare opozitare në miratimin nen për nen të nismës ligjore të paraqitur.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Naço.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thirrjet spekuluese që i bëni thirrje opozitës, se ju jeni të kulluarit në këtë botë, besoj se duhet t'i hiqni nga retorika. Po ta kishit menduar, këtu kemi qenë, duhet ta kishit kërkuar më përpara që të bashkëpunonim në lidhje me këtë proces ligjvënës.

Unë ju bëj thirrje edhe një herë, si ish-ministër i Drejtësisë, që kam pasur mjaft probleme me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të cilat janë bërë edhe publike, dhe ky ka qenë vetë qëllimi i reformës, madje do t'ju lutesha të mos i përzieni këta magjistratë me një pjesë të llumit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në qoftë se dikush do të bëjë qokën e radhës, e ka gabim që e ngatërron reformën në drejtësi për të bërë një apo dy ndere që duhen qoftë prokuror, qoftë gjyqtar, sepse ju doni t'ia çoni Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Po, mor, zotërinj, por vendet vakante i shpall Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe prej dy vjetësh e kam parë që nuk i shpallte as për Tiranën, as për Durrësin, por vetëm për Tropojën, për t'i thënë: “Do të vish në Tiranë? Ke punë me mua. Ndërtoji marrëdhëniet me mua që të të sjell në Tiranë, të të jap edhe votën në Tiranë”.

Doni të sillni përsëri të njëjtin sistem? Unë do t'ju lutesha edhe një herë që të mos i përzieni këta magjistratë të shkëlqyer me llumin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

Atëherë, ka një propozim për ta shtyrë shqyrtimin dhe miratimin nen për nen dhe në tërësi të këtij projektligji, për të gjetur ndoshta edhe një akord me opozitën lidhur me zgjidhjen më të mirë të mundshme brenda kuadrit kushtetues dhe ligjor që kemi, për t'i zgjidhur këto dy situata që na janë krijuar: e para, me emërimin dhe, e dyta, me pranimin në Shkollën e Magjistraturës.

E rëndësishme është që për njërën pikë jemi dakord, absolutisht. Pra, për nenin 170 zoti Naço thotë: “Ky është mendimi im, por për nenin 170, që ka të bëjë me kuotat e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, do të marr edhe mendimin e pjesës tjetër të grupit”.

Ne po e lëmë të hapur diskutimin dhe shqyrtimin nen për nen, për të vijuar në mbledhjen e radhës, pasi të kemi edhe një konsultim lidhur me projektligjin.

Po, zoti Naço.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Që të shtohet në procesverbal, për nenin 170 thashë që do ta votoj qoftë edhe në kundërshtim me vendimin politik, që mund të marrë Grupi Parlamentar i LSI-së. Pra, do të jetë vendim individual. Ndërsa për pjesën tjetër, për nenin 160, edhe sikur grupi im parlamentar të marrë vendim politik për ta votuar, vota ime do të jetë kundër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, sepse siç është shkruar, nuk mund të pranoj që t'i bashkoj me llumin, t'i jap edhe një herë shansin llumit që të përzihet me këta magjistratë!

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Atëherë, jemi dakord ta shtyjmë shqyrtimin nen për nen dhe miratimin në tërësi të këtij projektligji që kishim sot?

(Deputeti Braho flet pa mikrofon.)

Po e kaluam nen për nen do të duhet ta votojmë edhe në tërësi projektligjin. Nuk mundem. Kështu që i bie që shqyrtimin nen për nen dhe miratimin në tërësi të këtij projektligji ta lëmë në mbledhjen e radhës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I rëndësishëm është votimi në parim. Pra, në parim nisma e koleges Bushka dhe imja u votua, ndërsa shqyrtimin nen për nen dhe miratimin në tërësi të saj do ta bëjmë mbledhjen e radhës.

Në rendin e ditës së sotme kishim edhe një pikë të tretë, që kalon si pikë e katërt, në fakt, që është shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës së për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, ta mbaroj!

Po, do t'i falënderoj!

Edhe për shqyrtimin e kësaj projektrezolute jemi komision përgjegjës dhe relatore është caktuar kolegia Xhina.

Në fakt, do t'i kërkoja komisionit që këtë pikë, për shkak se mbledhja e komisionit shkoi shumë gjatë, ta kalojmë për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjej rastin të falënderoj të gjithë kolegët për durimin që patën sot, pasi kishim një rend dite shumë të gjatë e të ngarkuar, po ashtu falënderoj edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Shkollës së Magjistraturës, misioneve EURALIUS dhe OPDAT për impenjimin e treguar në diskutimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, një ndryshim shumë i rëndësishëm, që do t’i hapë rrugë emërimit të magjistratëve që do të diplomohen këtë vit, pse jo edhe konkursit të pranimit në Shkollën e Magjistraturës për vitet që do të vijnë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë!

Natyrisht, do të kërkoja bashkëpunimin e opozitës në diskutimin e këtij projektligji, sigurisht edhe mbështetjen e misioneve EURALIUS dhe OPDAT, për ta çuar deri në fund nismën tonë ligjvënëse (timen dhe të koleges Bushka) për t’u miratuar në seancë plenare me numrin e nevojshëm të votave.

Edhe një herë, faleminderit!

E mbyllim këtu mbledhjen e sotme të komisionit. Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t’ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA